



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 267 Akti

**Nr. 401 Vendimi
Tiranë, më 16.6.2021**

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar znj. Marie Tuma, në Tiranë, më 14.6.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Alketa Zifla**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D dhe Ë, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar) dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) më 15.1.2019 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Pamela Qirko dhe Xhensila Pine. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere, znj. Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.1.2019, u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionerja Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

5. Në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për znj. Alketa Zifla nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë, në përputhje me kreun IV të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklaramëve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

10. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e në vijim “DSIK”) dhe komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (këtu e në vijim “KLP”).

11. **ILDKPKI-ja**, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti është konstatuar se:

deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;

(b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

- (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- (d) nuk ka kryer deklaram të rremë dhe;*
- (e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

12. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim ka dërguar raportin e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

13. Komisioni i vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale në KLP ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

14. Në vijim janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

15. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit mbi të tria kriteret, në datën 26.5.2021 vendosi: i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

16. Subjekti, u njoftua përmes postës elektronike të datës 26.5.2021 në lidhje me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të drejtën e njohjes me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të drejtën për të paraqitur prova të reja ose thirrjen e dëshmitarëve në kuptim të barrës së provës si dhe të drejtën për të paraqitur shpjegime, deri më 9.6.2021. Në vijim¹, subjekti e ushtroi të drejtën e njohjes me provat e administruara gjatë hetimit administrativ.

17. Në datën 9.6.2021², subjekti rivlerësimit, dërgoi shpjegimet dhe provat e saj në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ.

18. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, me vendimin e datës 10.6.2021 vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

I. SEANCA DËGJIMORE

29. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në datën 14.6.2021 ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

¹ Subjekti mori një kopje elektronike të dosjes së hetimit, sipas deklaratës së datës 27.5.2021.

² Nëpërmjet postës elektronike dhe protokollit të institucionit.

29.1. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

30. Znj. Alketa Zifla ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ.

30.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

31. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

31.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

31.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

31.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

31.4. Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017³ dhe kreut VII të ligjit nr.84/2016 rezulton se, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

31.5. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga

³ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i papazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

32. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

32.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion, i cili pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit.

32.2. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive. Në deklaratën “Vetting” të dorëzuar në ILDKPKI më 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

33. Apartament banimi me sip. 59 m², blv. “**”, lagjja “****”, shkalla ***, ap. ***, Tiranë, identifikuar me nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012. Vlera **11.210.000** lekë. Zotëron 50 %.**

33.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar kredi me kushte lehtësuese, përfituar nga Bashkia Fier dhe Banka Kombëtare Tregtare, sipas kontratës bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.3.2012, në shumën 3.452.000 lekë dhe pjesa tjetër nuk është dorëzuar prindërve, sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., *** kol., datë 8.3.2016.

33.2 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: në deklaratën periodike vjetore 2012 subjekti ka deklaruar: pasuri e llojit “apartament banimi”, sip 59 m², të ndodhur në Tiranë, blv “****” pallatet “****”, shk. ***, ap. ***, identifikuar me nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, blerë me kredi me kushte lehtësuese nga Bashkia Fier dhe Banka Kombëtare Tregtare Vlera **3,452,000** lekë; pjesa takuese 100%.

Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

34. Nga hetimi administrativ⁴ konfirmohet regjistrimi i pasurisë së mësipërme në emër të subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit⁵ të saj.

34.1. Nga administrimi i dokumentacionit të depozituar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës ka rezultuar se pasuria është regjistruar në datën 17.3.2012⁶ në pronësi të subjektit të rivlerësimit mbi bazën e kontratës së shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012, të lidhur midis prindërve të subjektit, z. H. dhe znj. L. Ll., në cilësinë e shitësve dhe subjektit në cilësinë e blerësit. Sipas kësaj kontrate, prindërit i kalojnë subjektit pronësinë mbi pasurinë “apartament” me sip. 59 m², kundrejt çmimit 11.210.000 lekë, i paguar jashtë zyrës noteriale.

⁴ Kërkesë drejtuar ASHK-së Tiranë, me nr. ***, datë 11.9.2019; kthim përgjigjeje nr. ***, datë 3.10.2019.

⁵ Martesa është zgjidhur me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 3.5.2016.

⁶ Sipas dokumentacionit të administruar me shkresën nr. *** prot., datë 11.6.2020.

34.2. Nga administrimi i dokumentacionit të ILDKPKI-së, si dhe nga hetimi i Komisionit, kanë rezultuar disa fakte të tjera në lidhje me përfitimin e kësaj pasurie, të shoqëruara me deklarime të ndryshme çmimesh.

34.3. Më 21.12.2011, midis të të njëjtave palë, është lidhur kontrata e kaparit me nr. *** rep., nr. *** kol., me objekt sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në vlerën 5.000.000 lekë sipas kontratës së shitblerjes që do të nënshkruhej. Referuar kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se i ka dhënë babait të saj kaparin prej 1.500.000 lekësh, ndërsa në lidhje me pjesën tjetër të çmimit në shumën prej 3.500.000 lekësh do t'ia paguante pas përfitimit të kredisë bankare.

34.4. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periudike të vitit 2011 ndryshimin e interesave në të drejtat reale sipas kontratës së kaparit, duke përcaktuar burimin, vlerën e paguar dhe detyrimin e mbetur me përshkrimet përkatëse.

34.5. Në të njëjtën datë me lidhjen e kontratës së kaparit, pra, në datën 21.12.2011, prindërit e subjektit kanë lëshuar deklaratën noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., sipas së cilës kanë deklaruar se, pavarësisht lidhje së kontratës së kaparit, realisht nuk kanë marrë nga vajza e tyre kaparin në vlerën 1.500.000 lekë, por e kanë bërë këtë deklaram vetëm për ta ndihmuar atë në blerjen e apartamentit.

34.6. Në vijim, nga hetimi ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë lëshuar edhe dy deklarata të tjera noteriale, nëpërmjet të cilave kanë deklaruar çmimin e shitjes së pasurisë në shumën 3.452.000 lekë: **i)** deklaratë noteriale⁷ me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.3.2016 për efekt rivlerësimi kalimtar te subjektit, sipas së cilës, ndër të tjera deklarohet se: *“Nga vajza jonë kemi marrë vetëm shumën prej 3.452.000 lekë, që përfaqëson çmimin përfundimtar të shitjes së pasurisë ... Këtë shumë vajza jonë e ka përfituar nga kredia e lehtësuar nga Bashkia Fier pranë B***-së. Shuma prej 3.452.000 lekë ka kaluar në llogarinë tonë bankare pranë B***-së në datën 3.4.2012.”*; **ii)** deklaratë noteriale⁸ me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.8.2016, sipas së cilës deklarohet, ndër të tjera, se apartamenti bashkë me shtesën i janë shitur subjektit në vlerën 3.452.000 lekë.

34.7. Në lidhje me këto konstatime, subjekti është pyetur nga ILDKPKI-ja⁹ në datën 29.3.2016, e cila ka sqaruar, ndër të tjera, se *apartamenti është rivlerësuar, është vendosur në kontratën e shitblerjes çmimi 11,210,000 lekë, apartament i ngarkuar me barrë hipotekore në favor të kredisë së marrë në datën 3.4.2012, në shumën 3.452.000 lekë.*

34.8. Subjektit iu kërkuan shpjegime pas konstatimit gjatë hetimit administrativ të disa veprime juridike të kryera nga subjekti dhe prindërit e saj, të cilat referonin çmime të ndryshme në lidhje me përfitimin e kësaj pasurie.

34.9. Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se në lidhje me kontratën e kaparit nuk ka kryer asnjë pagesë në vlerën 1.500.000 lekë, por lidhja e saj ishte kriter i veçantë për përfitimin e kredisë. Gjithashtu, ka shpjeguar se për shkak të marrëdhënies së posaçme familjare me prindërit, kanë rënë dakord që ata të vijonin të jetonin në të njëjtën shtëpi, deri në përfundim të katit shtesë sipër këtij apartamenti, për të cilin kishin vlerësuar se koha e përfundimit të saj nuk do të zgjaste më shumë se 10 vjet. Vlerësimet përfundimtare dhe kompensimet në lidhje me pagesën e plotë të shumës 5.000.000 lekë për apartamentin e shitur me kontratë, duke marrë në konsideratë edhe periudhën e qëndrimit të prindërve në apartamentin e shitur prej tyre, do të bëheshin me realizimin e shtesës mbi këtë apartament ku ata edhe do të jetonin.

⁷ Vijon, pjesë e dokumentacionit të depozituar nga subjekti në ILDKPKI, si dhe dorëzuar përsëri gjatë procesit të rivlerësimit.

⁸ E konstatuar në dosjen e legalizimit, bashkëlidhur shkresës kthim përgjigjeje të ASHK-së Tiranë, nr. ***, datë 11.6.2020.

⁹ Shih procesverbalin e ardhur nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021.

34.10. Vlera e shënuar në kontratë nuk kishte shumë interes për ato, pasi pagesa e vlerës së shkruar në këtë kontratë nuk do të bëhej asnjëherë dhe shuma prej 3.500.000 lekësh që do të paguhej, do të lëvrohej ditë më vonë pas lidhjes së kontratës së kredisë dhe disbursimit të saj prej bankës. Subjekti ka vijuar shpjegimin edhe në lidhje me vlerën prej 11.210.000 lekësh të vendosur si çmim në kontratën e shitjes, duke sqaruar se ishte vendosur nga noteri si çmim minimal fiskal bazuar në udhëzimin e përbashkët nr. ***, datë 26.2.2008, të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Financave, pika 11, i cili detyron zyrtarë noterialë me pasojë penalizimi, për respektimin e çmimeve minimale fiskale të përcaktuara, duke e detyruar kështu të vendoste këtë çmim edhe në kontratë, si çmim minimal fiskal të pasurisë në zonën përkatëse. Në përfundim, subjekti e ka përmbyllur shpjegimin e saj, duke theksuar se nuk ka paguar asnjë vlerë tjetër përveçse shumës 3.452.000 lekë, të kaluar nëpërmjet transfertës bankare që përkon me momentin e disbursimit të kredisë bankare prej BKT-së.

34.11. Nga hetimi administrativ i Komisionit nuk rezultoi lidhja e ndonjë kontrate¹⁰ furnizimi me shërbimet utilitare në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të. Nisur nga ky konstatim, u pyet subjekti në lidhje me kohën e marrjes në dorëzim të apartamentit.

34.12. Subjekti ka shpjeguar se apartamenti nuk është marrë asnjëherë në dorëzim formalisht me ndonjë akt të veçantë, por është shfrytëzuar që prej momentit të nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe deri në muajin nëntor 2013, duke qëndruar aty së bashku me prindërit e saj në periudha të ndryshme kohore, ndërsa, që prej muajit dhjetor të vitit 2013 është shfrytëzuar plotësisht nga familja e saj, për shkak të transferimit me punë në Tiranë. Në vitin 2014, duke u ndodhur në situatë jo komode për shkak të sipërfaqes së vogël të apartamentit (59 m²), në të cilin ishin strehuar 7 persona: 2 prindërit dhe familja e subjektit prej 5 anëtarësh në atë kohë dhe në kushtet e marrëveshjes së pandryshueshme, të dakordësuar me prindërit e saj, që ata të jetonin në atë apartament deri në ndërtimin e katit shtesë, subjekti ka shpjeguar se ka qenë e detyruar të merrte me qira një banesë në afërsi të prindërve. Kontratat për energji elektrike dhe ujë vazhdojnë të jenë në emër të babait të saj, z. H. Ll.

Në lidhje me burimin e krijimit

35. Në deklaratën “Vetting”, si dhe në deklaratën vjetore 2012, u konstatua se në seksionin “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar: “*Kredi për blerje apartament banimi, sip. 59 m², bulv “***”, lagjja “***”, shk. ***, ap. ***, identifikuar me nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, blerë me kredi të lehtësuara nga Bashkia Fier dhe Banka Kombëtare Tregtare (në vijim “BKT”) sipas kontratës bankare datë 27.03.2012*”, si dhe ka dorëzuar dokumentacionin mbështetës¹¹.

35.1. Nga hetimi administrativ i Komisionit për këtë burim¹² ka rezultuar se, në datën 27.3.2012 është lidhur kontrata e kredisë bankare me nr. *** rep., nr. *** kol., midis subjektit në cilësinë e kredimarrëses, BKT-së dega Fier në cilësinë e kredidhënësit, si dhe M. Z. dhe E.Z. (përkatësisht ish-bashkëshorti dhe i biri i subjektit) në cilësinë e dorëzuesve, me objekt kreditimin në shumën 3,500,000 lekë, sipas objektit referuar në aneksin e çeljes dhe përdorimit të kredisë, bashkëlidhur kontratës.

35.2. Në aneksin e çeljes dhe përdorimit të kredisë, pika 2 e tij, është përcaktuar se “Kreditimi do të përdoret nga Kredimarrësi për blerje shtëpie”. Gjithashtu, në aneksin e elementeve specifike të kredisë është përcaktuar se shuma prej 3,500,000 lekësh do të përdoret për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit dhe shuma e disbursuar do të

¹⁰ Shkresa kthim përgjigjeje nr. ***, datë 3.10.2019 dhe shkresa kthim përgjigjeje nr. *** datë 19.9.2019.

¹¹ Kontratë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.3.2012, si dhe anekset bashkëlidhur; kontratë hipotekimi me nr.*** rep., nr. *** kol, *statement* bankar datë 1.3.2016.

¹² Shkresa me nr. *** prot., datë 11.9.2019; kthim përgjigjeje BKT-ja nr. *** prot., datë 27.9.2019 dhe kthim përgjigjeje BKT-ja nr. *** prot., datë 8.3.2021.

transferohet nga llogaria e kredisë në favor të shitësit, z. H. Ll. dhe znj. L. Ll. me transfertë bankare nëpërmjet BKT-së.

35.3. Për sigurimin e përmbushjes së detyrimit, është lidhur kontrata e hipotekimit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.3.2012, sipas së cilës është vendosur hipotekë në favor të BKT-së, konkretisht pasuria apartament prej 59 m², e cila tashmë kishte kaluar në pronësi të subjektit nëpërmjet shitblerjes në datën 9.3.2012 dhe e regjistruar në emër të saj.

35.4. Në vijim, ka rezultuar se¹³ hipoteka mbi apartamentin në favor të BKT-së është regjistruar në datën 28.3.2012.

35.5. Pas regjistrimit të hipotekës, ka rezultuar se në datën 30.3.2012 është disbursuar kredia në BKT¹⁴. Në vijim, në datën 3.4.2012 shuma në vlerën 3,452,000 lekë është transferuar në llogari të prindërve të subjektit me përshkrimin e transfertës “*Alketa Zifla sa kalon në favor të L. ose H. Ll., lik detyrimi për blerje apartamenti*”.

Mbi faktet në lidhje me përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese

36. Nga hetimi i kryer¹⁵ dhe nga konfirmimi¹⁶ i Entit Kombëtar i Banesave, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredi me kushte lehtësuese nga shteti si e pastrehë, nga Bashkia Fier, me interes në masën 3%, të subvencionuar, për blerje banese me kosto të ulët.

36.1. Nga administrimi i dokumentacionit në lidhje me përfitimin e kredisë nga Bashkia Fier kanë rezultuar këto fakte: a) më 12.2.2011, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar strehim për banesë me kosto të ulët. Referuar kësaj kërkesë, subjekti ka deklaruar mospasjen e ndonjë banese në pronësi të saj, mospërfitim banese nga ligji për privatizimin, shoqëruar me dokumentacionin mbështetës: i) 2 vërtetime¹⁷ lëshuar nga ZVRPP-ja Fier, të cilat vërtetojnë se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë të regjistruar pasuri të paluajthshme pranë ZVRPP Fier; ii) certifikatë personale dhe familjare të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Fier; iii) vërtetime punësimi për subjektin dhe ish-bashkëshortin e saj mbi të ardhurat e përfituara; iv) vërtetim lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, i cili vërteton se subjekti nuk ishte e regjistruar për qëllime tatimore; v) vërtetim lëshuar nga Prokuroria Fier, i cili vërteton se ndaj subjektit nuk kishte të regjistruar procedim penal; vi) vërtetim lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, i cili vërteton se ndaj subjektit nuk kishte filluar ndjekje penale; vii) referuar listës së fituesve të pastrehë për vitin 2012¹⁸, subjektit i është disbursuar shuma e kredisë në datën 30.3.2012.

Analiza ligjore e kriterëve për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese

37. Në kohën e përfitimit të kredisë lehtësuese ka qenë në fuqi ligji nr. ***, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar, (tashmë i shfuqizuar me ligjin nr. 22/2018). Qëllimi i këtij ligji ishte përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e sigurimit, të shpërndarjes, të administrimit dhe të planifikimit të programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, brenda juridiksionit të bashkisë përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

37.1. Kushtet dhe kriteret e përfitimit për programet e strehimit kanë qenë të parashikuara në kreun V, neni 17 e vijues, si dhe neni 25 i këtij ligji. Konkretisht, në nenin 18 të këtij ligji,

¹³ Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.6.2020.

¹⁴ Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.9.2019 nga BKT-ja.

¹⁵ Shkresë EKB-së nr. *** prot., datë 23.2.2021; kthim përgjigjeje nr. ***, datë 26.2.2021, nëpërmjet së cilës Komisioni informohet se “subjekti nuk ka përfituar kredinë si zyrtare e lartë e administratës shtetërore, por si kredi për të pastrehë, akorduar nga Bashkia Fier”; shkresë Bashkisë Fier me nr. *** prot., datë 3.3.2021.

¹⁶ Kthim përgjigjeje EKB-ja, nr. ***, datë 26.2.2021; kthim përgjigjeje Bashkia Fier nr. *** prot., datë 6.4.2021.

¹⁷ Vërtetim me nr. *** prot., datë 4.3.2011 dhe vërtetim nr. *** prot., datë 13.10.2011.

¹⁸ Pjesë e praktikës bashkëlidhëse me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.4.2021 e Bashkisë Fier.

përcaktoheshin kriteret mbi bazën e të cilave përfitonin të pastrehët:... a) *familjet që në çastin e paraqitjes së kërkesës pranë zyrës përkatëse të bashkisë nuk kanë në pronësi një banesë; ...* Gjithashtu, në dispozitat e përgjithshme në lidhje me kriteret përfituese të programeve sociale, në nenin 5 “Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve” përcaktohej se trajtohen me përparësi: a) *familjet, të cilat vërtetojnë se nuk kanë përfituar nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”.*

37.2. Rezulton se në kohën e paraqitjes së kërkesës për përfitim banese, subjekti ka qenë e martuar, me tre fëmijë, si dhe e regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile Fier. Gjithashtu, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë qenë të punësuar në Fier¹⁹ (subjekti si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Fier, ndërsa ish-bashkëshorti i saj, aktor pranë Drejtorisë së Artit dhe Kulturës, Bashkia Fier) dhe banonin me qira në një apartament, sipas kontratës së qirasë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.12.2008.

37.3. Gjithashtu, nga administrimi i dokumentacionit²⁰, ka rezultuar se në kohën e aplikimit të subjektit për programet sociale të strehimit, ish-bashkëshorti i saj ka qenë i angazhuar në një marrëdhënie shitblerjeje (me rezervë e pronës), sipas kontratës së shitjes me këste me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.5.2006, për blerjen e një apartamenti në Tepelenë, bashkë me të atin. Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me këtë pasuri²¹, ka rezultuar se kontrata e shitjes me këste është lidhur sipas ligjit nr. 9416, datë 20.5.2005, “Për procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fonde shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave”, ku apartamenti i cili i është shitur ish-bashkëshortit të subjektit, është blerë me fonde shtetërore.

37.3.1. Por, në kuptim të parimit *shtrirje në hapësirë* të ligjit nr. 9232/2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, ekzistenca e një pasurie, e përfituar nga bashkëshorti i subjektit nëpërmjet privatizimit në Tepelenë, në kohën e aplikimit për kredi si e pastrehë nga subjekti në qytetin Fier, për trupin gjykues, nuk përbën kriter skualifikues për subjektin, për sa pasuria e përfituar ndodhej jashtë juridiksionit territorial të Bashkisë Fier dhe se vërtetohej nga vërtetimet e pasurive të lëshuara nga ZVRPP-ja Fier se subjekti nuk kishte pasuri në pronësi në këtë qytet.

37.4. Bazuar në nenin 25 të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, në fuqi në kohën e përfitimit të kredisë nga subjekti i rivlerësimit, ka qenë e përcaktuar se *“familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët kanë të drejtën e marrjes së një kredie hipotekore, me kushte lehtësuese, nga një institucion financiar që ka lidhur kontratë me Ministrinë e Financave për menaxhimin e kredive”.*

37.5. Pas analizimit të kriterëve ligjore dhe rrethanave të përfitimit të kredisë, rezultoi se subjekti kishte përfituar nga kredi me kushte lehtësuese me statusin e të pastrehëve, të miratuar nga Bashkia Fier dhe të ekzekutuar nga BKT-ja, si institucion financiar kredidhënës, sipas kontratës së kredisë së datës 27.3.2012, në shumën 3,500,000 lekë, të cilën e përdori për blerjen e apartamentit prej 59 m² jashtë juridiksionit të Bashkisë Fier.

Në lidhje me pagesën e kësteve të kredisë me kushte lehtësuese

38. Referuar lëvizjeve të llogarive bankare pranë BKT-së²², ka rezultuar se shuma prej 3,500,000 lekësh, e cila është disbursuar në datën 30.3.2012 si kredi në favor të subjektit, është transferuar në datën 3.4.2012 në vlerën 3,452,000 lekë, në llogari të prindërve të subjektit si

¹⁹Shih vërtetimet e punësimit në dosjen e aplikimit, sipas shkresës kthim përgjigje të Bashkisë Fier, nr. *** prot., datë 6.4.2021.

²⁰Shkresë drejtuar ASHK-së, nr. *** prot., datë 11.9.2019 dhe nr. *** prot., datë 4.5.2020, si dhe nga vlerësimi i dokumentacionit në kuadër të kontrollit të ILDKPKI-së, si dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetjes 4 të pyetësorit 2.

²¹ Në pyetësorin e 2-të.

²²Kthim përgjigjeje BKT-ja nr. *** , datë 27.9.2019.

palë shitëse, me përshkrimin e transfertës “*Alketa Zifla sa kalon në favor të L. ose H. Ll., lik detyrimi për blerje apartamenti*”. Kjo shumë është investuar po në BKT nga prindërit e subjektit gjatë periudhës 2012 – 2016²³ në depozitë me afat (bono thesari) dhe të gjitha interesat e përfituara në vlerën 665,000 lekë për këtë periudhë, si rrjedhojë e këtyre investimeve, janë transferuar nga llogaria e prindërve në llogari të kredisë së subjektit Alketa Zifla, të cilat kanë shërbyer për të paguar këstet e kredisë së subjektit për blerjen e apartamentit.

38.1. E pyetur²⁴ nga Komisioni, subjekti konfirmoi faktin se i ati e ka ndihmuar në shlyerjen e kësteve mujore, duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin provues: a) *statement* të llogarisë së përbashkët të prindërve L. dhe H. Ll., prej datës 3.4.2012 deri në datën 9.10.2019 pranë BKT-së; b) vërtetim për një prej blerjeve të obligacioneve në tregun primar, datë 22.6.2015; c) transferim nga llogaria e H. Ll. në llogari investimi për bono thesari 6-mujore, datë 5.4.2012 ç) *statement* të llogarisë së përbashkët të L. dhe H. Ll. dhe llogarinë personale të H. Ll., nga e cila janë kryer transfertat në llogarinë e kredisë.

38.2. Komisioni konstatoi se subjekti nuk kishte deklaruar në deklaratat periodike përkatëse vjetore, as në “Vetting” dhurimet e kryera nga babai në formën e shlyerjes së kredisë, sipas nenit 4 pika f²⁵ e ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, shtuar me ligjin nr. 85/2012, për të cilin iu kërkuan shpjegime dhe u vlerësuan nga trupi gjykues në tërësi me çështjet e rezultuara në kuadër të konkluzioneve të hetimit për këtë pasuri, sikundër vijon më poshtë.

Në lidhje me konfliktin e interesit

39. Gjatë hetimit administrativ, është pyetur²⁶ subjekti nëse gjatë karrierës së saj pranë Prokurorisë Fier ka pasur në hetim kallëzime të paraqitura nga/apo ndaj Bashkisë Fier ose punonjës, zyrtarë të këtij institucioni, për të cilët ka disponuar me vendim.

39.1. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit, është shprehur: “*Deri në datën 27.03.2012 nuk kam pasur dosje procedimi penal, të mosfilluara, pushuara, pezulluara apo të dërguara për gjykim ku si kallëzues/të kallëzuar persona ndaj të cilit zhvillohen hetime, të dëmtuar, të pandehur të ketë qënë Bashkia Fier dhe ose punonjës, zyrtarë të këtij institucioni. Më 16.7.2012, me cilësinë e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, kam trajtuar kallëzimin penal nr. *** të regjistruar mbi bazën e kallzimit të disa qytetarëve të qytetit Fier. Më 30.07.2012, kam vendosur mosfillimin e këtij procedimi penal në bazë të nenit 290, pika 1, germa ç, dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale*”. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës vërtetim nr. *** prot, datë 11.11.2020, lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, për të provuar deklarinë e saj.

39.2. Pas administrimit të deklarinë të subjektit, Komisioni, për shkak të konstatimit të elementit “kohë e afërt” të kallëzimit të datës 16.7.2012 me kredinë lehtësuese (disbursuar në datën 30.03.2012), vlerësoi të administronte²⁷ në cilësinë e provave fashikujt e procedimit penal, të cilët lidheshin me kallëzimin e trajtuar nga subjekti.

²³ Në datën 31.12.2016 shuma e depozitës vijon të jetë ende 3,500,000 lekë e investuar në depozitë me afat (obligacione) në favor të prindërve të subjektit dhe nuk rezulton të jetë përdorur prej tyre, sipas shkresës së BKT-së nr. *** , datë 20.5.2020.

²⁴Pyetësori nr. 2.

²⁵ Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë: f) *dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtim preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10, 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi;*

²⁶ Pyetësori nr. 3, pyetja 1/a.

²⁷Administrimi i akteve u krye nga dosja e subjektit B. C., me vendim të ndërmjetëm të trupit gjykues datë 27.4.2021. Këta fashikuj janë përdorur nga Komisioni për hetimin e kryer ndaj këtij subjekti dhe janë tërhequr

39.3. Nga administrimi i këtyre fashikujve ka rezultuar se në datën 16.7.2012, nga Prokuroria Fier, mbi bazën e kallëzimit të 15 ankuesve, është regjistruar kallëzimi penal nr. ****. Në kallëzim ndër të tjera, qytetarët referojnë se kanë paraqitur kërkesa për t'u trajtuar me banesa sociale dhe kanë pretenduar parregullsi në miratimin e listës së përfituesve në datën 9.7.2012. Për këtë qëllim kanë kallëzuar punonjës dhe zyrtarë të lartë të kësaj bashkie. Me vendimin e datës 30.7.2012, subjekti rivlerësimi ka vendosur “mosfillimin e procedimit penal”, duke arsyetuar se: “...fakti përveç që nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, është rrjedhojë e një votimi të fshehtë kolegjal dhe objekt i një procedure ankimi administrativ, e cila edhe është ndjekur në rastin konkret”.

39.4. Rezulton se ky vendim është ankimuar nga kallëzuesit dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e datës 6 shkurt 2013 ka vendosur “pranimin e kërkesës për prishjen e vendimit të mosfillimit” dhe ka urdhëruar Prokurorinë Fier të vijojë me kryerjen e veprimeve hetimore. Në zbatim të vendimit të Gjykatës, Prokuroria Fier ka vijuar me regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore, nga ku është konkluduar me dërgimin në gjykatë të disa personave punonjës zyrtar të Bashkisë Fier.

39.5. Pavarësisht vendimmarrjes së subjektit, nga administrimi i materialit hetimor, si dhe duke vlerësuar pjesëmarrjen e znj. Zifla në hetim, rezulton se ajo gjendej në rrethanat e dorëheqjes²⁸ nga hetimi i kësaj çështjeje, në kuptim të neneve 26 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe ligjit nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, për arsye të: a) kohës së afërt të përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese; dhe b) faktet dhe rrethanat e përfitimit të kësaj kredie, si dhe përdorimin e saj për blerjen e pasurisë jashtë juridiksionit të Bashkisë Fier.

39.6. Bazuar në nenin Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me këtë pasuri për sa rezultoi se: a) ka mospërputhje në deklaratën periodike 2012 me deklaratën “Vetting”, në lidhje me deklarinimin e çmimit për blerjen e pasurisë apartament 59 m²; b) subjekti ka ndërmarrë një sërë veprimesh fiktive për përfitimin e pasurisë “apartament”, të cilat nuk kanë pasur qëllim ardhjen e pasojave të caktuara juridike si: i) lidhjen e kontratës së kaparit të paekzekutuar ndonjëherë; ii) blerjen e apartamentit kundrejt një çmimi të papaguar ndonjëherë, iii) faktet në lidhje me përdorimin e pasurisë; b) subjekti nuk e ka përdorur kredinë për të siguruar strehimin në Fier (pra, brenda juridiksionit territorial të Bashkisë Fier) dhe ka ndërmarrë një sërë hapash dhe veprimesh juridike, vetëm në funksion të plotësimit formal të kushteve të përfitimit të kredisë lehtësuese; c) subjekti ka përdorur interesat e përfituara nga investimi i fondit të kredisë së marrë nga BKT-ja nga prindërit e saj, për të ripaguar interesat e kësaj kredie gjatë viteve, si dhe nuk i ka deklaruar në deklaratat e pasurisë si të ardhura të dhuruara nga prindërit, sipas nenit 4²⁹, pika “f” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar; d) rezulton se subjekti ka qenë në kushtet e dorëheqjes nga shqyrtimi i kallëzimit të datës 16.7.2012, sipas nenit 26 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas rezultateve të hetimit

40. Në shpjegimet përfundimtare, subjekti konfirmoi të njëjtin qëndrim, sikundër gjatë hetimit administrativ, duke shpjeguar arsyet në lidhje me kryerjen e veprimeve juridike mes saj dhe prindërve të saj, të cilat, sipas subjektit, kanë pasur qëllim vetëm strehimin.

nga protokollin e Komisionit, për shkak se dosja e këtij subjekti është kthyer në Komision, pasi vendimi ka marrë formë të prerë me vendimin nr. 2, datë 27.2.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

²⁸Për shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.

²⁹ Shtuar me ligjin nr. 85/2012.

40.1. Në lidhje me mospërputhjen e çmimit, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se: a) kontrata e kaparit ishte lidhur për të plotësuar kushtin formal të bankës për lëvrimin e kredisë; b) shuma prej 1,500.000 lekë nuk është disponuar asnjëherë prej saj; c) çmimi në kontratën e shitjes në vlerën 11.210.000 lekësh ishte vendosur nga noteri pas krahasimit të çmimit të rivlerësuar të pasurisë dhe çmimit të referencës së pasurive të paluajtshme në atë zonë.

Bazuar në këto argumente, subjekti pretendoi se vendosja e këtij çmimi shitjeje gjithashtu nuk mund të konsiderohet nga Komisioni, si një veprim fiktiv i kryer prej saj, sepse ka qenë thjesht dhe vetëm vijim i përpjekjeve të vazhdueshme, në kushtet e mungesës së çfarëdo alternative tjetër. Veprimet janë kryer me vendime të përbashkëta mes saj dhe prindërve, në funksion të qëllimit të vetëm: zgjidhjes përfundimtare të strehimit të familjes së subjektit të rivlerësimit.

40.2. Në lidhje me ndërmarrjen e një sërë veprimesh fiktive për përfitimin e pasurisë “apartament”, të cilat nuk kanë pasur qëllim ardhjen e pasojave të caktuara juridike, subjekti ka shpjeguar se: a) të gjitha veprimet e ndërmarra prej saj nuk janë veprime fiktive, por ka qenë mundësia e vetme e këshilluar nga agjentët e kreditit të bankës për garantimin e kredisë; b) faza e pajisjes së prindërve të saj me leje ndërtimi për shtesën e katit të banesës ka rënduar situatën financiare dhe psikologjike të familjes së saj, që jeton me qira në një tjetër banesë; c) veprimet juridike të kryera kanë sjellë pasojën juridike të regjistrimit të apartamentit në pronësinë e saj.

40.3. Si dokumentacion justifikues ka bashkëlidhur kopje të projektit të shtesës së katit, vërtetim nga Gjykata e Apelit Tiranë, si dhe një kopje të certifikatës së pronësisë së një prej bashkëpronarëve, fqinj në banesën e saj, për të provuar faktin e një konflikti gjyqësor civil mes bashkëpronarëve të pallatit, si një prej faktorëve që mban peng arritjen e dakordësisë mes tyre.

40.4. Në lidhje me konstatimin e përdorimit të kredisë për blerjen e banesës jashtë juridiksionit të Bashkisë Fier, subjekti ka shpjeguar se: a) ligji nr. 9232/2004 parashikon se e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; b) termi “juridiksion” dikton ndërtimin brenda territorit të asaj bashkie, por të jo të blerjes së apartamenteve. Për rrjedhojë, subjekti ka pretenduar se nuk ka pasur pengesë për blerjen e pasurisë në një tjetër bashki; c) në lëvrimin e kredisë nuk është përdorur si bazë ligjore vetëm ligji i mësipërm, por edhe VKM-ja nr. 600/2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”; d) kredia e marrë nga ana e saj është kryer konform parashikimit ligjor të VKM-së nr. 814/2004, si dhe vendimit nr. 169, datë 19.6.2019 të KPK-së, në një situatë analoge me rastin e saj, (kredi me kushte lehtësuese, e marrë për një banesë jashtë juridiksionit të rrethit ku është marrë), ku pranohet se kredia është akorduar konform ligjit.

40.5. Në lidhje me konstatimin se ka përdorur interesat e përfituara nga investimi i fondit të kredisë së marrë nga BKT nga prindërit e saj, për të ripaguar interesat e kësaj kredie, subjekti ka shpjeguar se: a) shumat, që prindërit kanë kaluar në llogarinë e saj, kanë shërbyer për shlyerjen e disa prej kësteve të kredisë, me marrëveshje mes tyre, për kompensimin në një lloj forme të qirasë, të cilën do të paguanin nëse do të largoheshin nga apartamenti që i kishin shitur; b) këto shuma nuk kanë shërbyer si burim për krijim pasurie në favorin e saj, por si mbulim dhe kompensim shpenzimesh; c) mospasqyrimi i tyre ka ndodhur për moskuptim të deklaratës vjetore. Subjekti ka parashtruar se për mënyrën se si ka deklaruar shpenzimet për qira në DPV-të përkatëse, rezultojnë të dubluara në tabelën përmbledhëse të llogaritjes financiare nga Komisioni në vlerën totale të konstatuar prej 665.00 lekësh dhe ka kërkuar të reflektohet ky ndryshim, duke i zvogëluar këto shuma deri në këtë vlerë.

40.6. Në lidhje me sa rezultoi nga hetimi se duket se subjekti ka qenë në kushtet e heqjes dorë nga shqyrtimi i kallëzimit të datës 16.7.2012, subjekti ka sqaruar se: a) vendimmarrja e saj daton pas përfundimit të procedurës për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese; për këtë arsye, ka gjykuar se nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit; b) Në vijim të këtij arsyetimi, subjekti nuk ka gjykuar se si pjesë e Task-Forcës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, me vetëm 3 prokurorë, do t'i duhej të hiqte dorë nga çdo shqyrtim në të ardhmen të

çështjeve që kishin lidhje me Bashkinë Fier; c) çështja i është caktuar nga drejtuesi i Prokurorisë dhe si e tillë e detyrueshme për t'u zbatuar, bazuar në nenin 24 pikat 4 dhe 5 të K.Pr.Penale në fuqi në vitin 2012; d) vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nuk është ankimuar prej saj, me qëllim shmangien e çdo paragjykimi të vendimmarrjes së saj; e) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur pafajësinë e të pandehurve, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

41. Trupi gjykues, pas administrimit të prapësimeve të detajuara të subjektit mbi rezultatet e hetimit administrativ, si dhe shpjegimeve të përmbledhura në seancë dëgjimore, analizoi provat dhe faktet sipas legjislacionit në fuqi dhe vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me pasurinë “apartament” me sip. 59 m², për arsyet e mëposhtme:

a) Në lidhje me faktin e kryerjes së një sërë veprimesh të simuluar nga subjekti, të cilat nuk kanë pasur qëllim ardhjen e pasojave juridike

a.1. Si fillim, trupi gjykues vlerëson të theksojë se, verifikimi i mënyrës së përfitimit të kredive, si burim krijimi të pasurive, si dhe qëllimi i përdorimit të tyre, përfaqëson një proces të rëndësishëm, i cili duhet kryer si pjesë e verifikimeve në kuadër të procesit të rivlerësimit, në zbatim të detyrimit kushtetues të parashikuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese është kryer edhe procesi i verifikimit të burimeve të krijimit për pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

a.2. Në shpjegimet përfundimtare, subjekti pretendoi se kontrata e kaparit ka qenë kriter i veçantë i bankës për përfitimin e kredisë, ku shuma prej 5,000,000 lekësh përkonte me rregullin e bankës, sipas të cilit banka mbulonte vetëm 75% të vlerës së banesës dhe pjesa tjetër prej 1,500,000 lekë duhej të mbulohej prej përfituesit të kredisë.

a.3. Nga administrimi i dokumentacionit bankar nga Banka Kombëtare Tregtare gjatë hetimit administrativ, nuk rezultoi ndonjë kriter bankar “garantor” të natyrës së kaparit i lidhur me përfitimin e kredisë. Përkundrazi, rezultoi se për sigurimin e përmbushjes së detyrimit sipas kredisë, ishte vendosur hipotekë vetë apartamenti, për blerjen e të cilit ishte marrë kredia.

a.4. Referuar kontratës së kaparit të datës 21.12.2011, apartamenti do t'i shitej subjektit nga prindërit e saj kundrejt çmimit prej 5,000,000 lekë, ndërkohë rezultoi sipas kontratës së shitblerjes së datës 9.3.2012, se çmimi i shitjes është 11,210,000 lekë.

a.5. Në lidhje me pretendimin e subjektit se çmimi prej 11,210,000 lekësh i vendosur nga noteri në kontratën e shitblerjes ka qenë çmim detyrues sipas udhëzimit të përbashkët nr. 9/2008, të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Financave, pika 11 e tij, edhe ky pretendim nuk qëndron për arsyet si vijon: a) trupi gjykues konstaton se udhëzimi nr. 9, datë, 26.2.2008 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë” ka dalë në bazë dhe zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, me qëllim rregullimin e përcaktimit të tatimit në rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme. Ky udhëzim, në nenin 5 të tij parashikon se: *“Përcaktimi i vlerës në shitje bazohet në kontratën e shitjes së pasurisë. Në rastet kur çmimi i shitjes për m² i përcaktuar në kontratë është më i ulët se çmimi minimal i përcaktuar në shtojcat nr. 2 dhe 3 bashkëngjitur këtij udhëzimi, zbatohen këta të fundit për efekt të llogaritjes së tatimit”*. Neni 11 i këtij udhëzimi, që referon subjekti, përcakton detyrimin e zyrave noteriale për njohjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi, për qëllim të caktimit të çmimit për efekt të llogaritjes së tatimit. Nën këtë rregullim ligjor, trupi gjykues arrin në përfundimin se ky udhëzim rregullon mënyrën e mbajtjes së tatimit në burim në rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme dhe detyrimin për zbatim nga organet e përcaktuara në të përfshirë dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të

paluajtshme, si agjentë të mbajtjes së tatimit në burim, **vetëm për qëllim** të llogaritjes së tatimit, por nuk detyron palët në vullnetin e tyre kontraktual për caktimin e çmimit.

a.6. Subjekti pretendoi se veprimet ligjore e kanë sjellë pasojën juridike me arsyetimin se: *“Në këndvështrim të dispozitave të Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore që rregullojnë fitimin e pronësisë për pasuri të paluajtshme, veprimet juridike të kryera nga ana ime për fitimin e pronësisë mbi apartamentin, e kanë sjellë pasojën juridike: Regjistrimi i apartamentit në regjistrat të pasurive të paluajtshme të zonës ku ndodhet banesa, në pronësinë time.”* Trupi gjykues vlerëson të ndalojë në këtë paragraf për të arsyetuar në lidhje me fiktivitetin e veprimit juridik dhe pasojat juridike të tij.

a.7. Neni 92 i Kodit Civil parashikon se veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Në kuptim të ligjit konsiderohen veprime të tilla ato që bëhen me marrëveshje pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar).

a.8. Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me Vendimin Unifikues nr. 932, datë 22.06.2000, kanë unifikuar qëndrimin në lidhje me vlerësimin e veprimeve fiktive, duke u shprehur se: *“Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit, mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e **duan vetë palët e veprimit juridik**. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik, të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezulton prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre.”*

a.9. Fiktiviteti përfaqëson një dukuri, e cila lidhet me fakte dhe rrethana të pavërteta. Për rregullimin e pasojave civile që vijnë nga ky fenomen, ligjvënësi ka parashikuar institutin e pavlefshmërisë së veprimeve juridike, i cili parashikohet në nenet 92 e vijues të Kodit Civil. Në këtë kuptim, pa paragjykuar vlerën e kontratës së kaparit të datës 21.12.2011, hartimi i një kontrate ligjore, vetëm për t’iu paraqitur bankës në funksion të përfitimit të kredisë dhe jo sipas qëllimit të vetë palëve, përmban elemente të fiktivitetit, pasi marrëveshja e palëve kontraktore nuk ka pasur qëllim që të sjellë pasojat juridike të ligjshme. Ky konkluzion përputhet edhe me vetë deklaratën noteriale të prindërve të subjektit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.12.2011, të cilët kanë deklaruar se *“realisht nuk kemi marrë nga vajza jonë kaparin prej 1,500,000 lekë por e kemi bërë vetëm për ta ndihmuar atë në blerjen e apartamentit të cituar në kontratë”*.

a.10. Duket qartë që për shkak të marrëdhënies së posaçme të subjektit me prindërit e saj, rrethi i transaksioneve është mbyllur pa u kundërshtuar midis tyre dhe pasuria ka kaluar në pronësinë e subjektit, si dhe është regjistruar në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme. Por, kjo nuk do të thotë se lidhja e kontratës së shitblerjes, sipas së cilës ka kaluar pronësia e pasurisë tek subjekti, ka legalizuar veprimet e kryera në funksion të përfitimit të kësaj pasurie. Trupi gjykues thekson se, qëndrimi i subjektit vjen në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore mbi fitimin e pronësisë (neni 705 e vijues i Kodit Civil) pasi, referuar këtyre dispozitave, pronësia mbi pasuritë e paluajtshme fitohet me lidhjen e kontratës së pasurisë së paluajtshme dhe pagesën e çmimit, tipar ky i kontratës konsensuale. Regjistrimi më pas në regjistrat publikë të titullit të pronësisë nga përfituesi i këtij titulli përfaqëson një veprim administrativ publik me qëllim që pasuria të njihet kundrejt të tretëve.

a.11. Trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës mbi kryerjen e veprimeve juridike të simuluar. Përkundrazi, gjatë hetimit administrativ si dhe në përfundim të tij, rezultoi i qartë vullneti i subjektit për kryerjen e këtyre veprimeve në marrëveshje me prindërit e saj vetëm për përfitimin e kredisë. Ky konkluzion është i bazuar edhe në praktikën e konsoliduar, tashmë, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit në lidhje me trajtimin e elementeve fiktive në rastet e kredive me kushte lehtësuese³⁰.

³⁰ Vendim i KPA-së nr. 28/2019 JR, datë 30.10.2019.

b) Në lidhje me faktin e përdorimit të kredisë me kushte lehtësuese për strehim jashtë juridiksionit territorial të Bashkisë Fier dhe ndërmarrjen e një sërë veprimesh juridike vetëm në funksion të plotësimit formal të kushteve me qëllim përfitimin e kredisë lehtësuese

b.1. Në lidhje me çështjen e përfitimit të kredisë lehtësuese si dhe përdorimit të saj jashtë juridiksionit territorial të Bashkisë Fier, subjekti ka shpjeguar se në interpretim të dispozitave ligjore për strehimin, termi “juridiksion” u referohet ndërtimeve nga ana e njërive të qeverisjes vendore për banesat sociale me qira, ku natyrshëm banesat do të ndërtohen brenda territorit të bashkisë përkatëse, por jo në rastet e blerjes së apartamenteve. Sipas subjektit nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore që me kredinë e përfituar, të blinte banesën në një territor të një bashkie tjetër. Subjekti, gjithashtu ka pretenduar se kredinë e ka përfituar edhe me VKM-në nr. 600/2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”.

b.2. Nga analizimi i shpjegimeve të subjektit në lidhje me çështjen e përfitimit të kredisë lehtësuese, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit jo vetëm që nuk janë bindëse, por në vlerësim të trupës gjykuese vijnë si zbatim i gabuar i ligjit nr. 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

b.3. Sikundër rezultoi nga hetimi dhe analiza ligjore e kryer nga Komisioni, subjekti ka plotësuar dokumentacionin për përfitimin e kredisë me qëllim strehimin në një banesë me kosto të ulët drejtuar Bashkisë Fier në datën 12.2.2011. Dokumentacioni është plotësuar nga subjekti për të vërtetuar gjendjen e fakteve (fakti i vërtetimit të mospasjes së një banese në pronësi të subjektit, gjendjes civile, vendbanimi etj.) brenda juridiksionit territorial të Bashkisë Fier. Në vitin 2012, Këshillit Bashkiak i Bashkisë Fier, pas vlerësimit të dokumentacionit ka disponuar për miratimin e kredisë me kushte lehtësuese për subjektin e rivlerësimit dhe 28 qytetarë të tjerë për qytetin Fier. Vlera e kredisë së miratuar për subjektin e rivlerësimit ka qenë në shumën 3,500,000 lekë, e cila është disbursuar pas nënshkrimit të kontratës me BKT-në Fier në datën 27.3.2012.

b.4. Në kohën e aplikimit për kredi lehtësuese, ka qenë në fuqi ligji nr. 9232/2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i cili në nenin 1 të tij parashikonte midis të tjerave se ligji e shrinte veprimtarinë e tij në gjithë territorin, nën juridiksionin e bashkive të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa në nenin 35 të tij parashikohet se janë bashkitë ato që identifikojnë nevojat për strehim, sipas programeve të hartuara në bazë të këtij ligji për popullsinë nën juridiksionin territorial të tyre.

b.5. Nga analiza e fakteve rezulton se subjekti nuk e përdori kredinë për qëllim strehimi në një nga banesat me kosto të ulët brenda juridiksionit territorial ku shtrihet kjo bashki.

b.6. Ky konkluzion vjen duke u bazuar edhe në faktet se kredia u përdor për blerjen e një apartamenti në Tiranë, me një vlerë shumëfish më të lartë (në shumën 11,210,000 lekë) sesa vlera e përcaktuar nga Ministria e Punëve Publike dhe e Transportit³¹ në shumën 4,487,520 lekë³², si banesë me kosto të ulët, duke tejkaluar për rrjedhojë nevojën për strehim të subjektit të rivlerësimit.

b.7. Subjekti ka arsyetuar se nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore që me kredinë e përfituar të blinte një banesë në territorin e një bashkie tjetër, duke e bazuar arsyetimin në nenin 1, pika 2 të ligjit nr. 9232/2004, por trupi gjykues konstaton se kjo dispozitë ka hyrë në fuqi pas përfitimit të kredisë, me ligjin nr. 54/2012, datë 10.5.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9232/2004”.

³¹ Ministria kompetente për strehimin, sipas nenit 19 të ligjit nr. 9232/2004.

³² Referuar përcaktimit në nenin 5 të kontratës së kredisë datë 27.3.2012.

b.8. Në shpjegimet e saj subjekti ka pretenduar se kredia është marrë edhe me VKM-në nr.600/2007, duke iu referua kontratës së kredisë bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.3.2012, në të cilën është përdorur si bazë ligjore ky Vendim i Këshillit të Ministrave dhe jo vetëm ligji nr. 9232/ 2004.

b.9. Trupi gjykues, në këtë kontekst, vlerëson të theksojë përsëri se kredia e përfituar nga subjekti i rivlerësimit ka qenë kredi me kushte lehtësuese, e cila i është akorduar si qytetare e pastrehë, në bazë të ligjit nr. 9232/2004. Ky fakt rezultoi nga hetimi i Komisionit, sipas të cilit EKB-ja³³ konfirmon se znj. Alketa Zifla nuk ka përfituar kredi nga programi i strehimit si zyrtare e lartë e administratës shtetërore, në zbatim të VKM-së nr. 600/2007, por ka përfituar kredi me kushte lehtësuese nga Bashkia Fier, sipas ligjit nr. 9232/2004.

b.10. Trupi gjykues konstaton se në nenin 1 të kontratës së kredisë bankare, të cilit i referohet subjekti, është përcaktuar e gjithë baza ligjore që lidhet me kreditë lehtësuese të subvencionuara, përfshirë këtu edhe bazën ligjore për rregullimin e kredive me kushte lehtësuese, sipas VKM-së nr. 600/2007. Trupi gjykues vlerëson se kjo është një dispozitë *tip*, e vendosur nga banka për efekt ekonomizimi të kornizës ligjore, e cila rregullon të gjitha kreditë me kushte lehtësuese lehtësuese, për akordimin e të cilave banka ka marrëveshje me institucionet kompetente. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion për sa u provua nga hetimi lidhur me natyrën e kredisë së përfituar nga subjekti, si edhe në interpretim të dispozitave të kësaj kontrate, që lidhen me vlerën e kredituar, sipas nenit 2 të kontratës në shumën 3,500,000 lekë, interesin e paguar nga kredimarrësi në masën 3% sipas nenit 5, kushte këto të cilat ndryshojnë në rastet e kreditimit sipas VKM-së nr. 600/2007 për kredimarrësit funksionarë të lartë, përkatësisht vlera e kredituar është deri në 5 milionë lekë dhe interesi për t'u paguar është në masën 4 %³⁴.

b.11. Nga analiza e fakteve dhe ligjit të mësipërm, trupi gjykues arrin në konkluzion se, subjekti me veprimet e kryera ka pasur qëllim përfitimin e kredisë dhe jo strehimin brenda juridiksionit territorial të Bashkisë Fier në një banesë me kosto të ulët, sikurse kërkohej nga ligji nr. 9232, datë 13.05.2004 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, duke qenë se nga hetimi rezultuan fakte të pakundërshtueshme si: i) përdorimi i kredisë për blerjen e apartamentit në Tiranë kundrejt çmimit 11,210,000 lekë në kushtet kur për shkak të natyrës së kredisë lehtësuese, vlera e banesës, ishte përcaktuar nga Ministria e Punëve Publike dhe e Transportit³⁵ në shumën 4,487,520 lekë³⁶, si banesë me kosto të ulët; ii) subjekti e kishte fituar pronësinë mbi apartamentin, objekt kreditimi që në datën 9.3.2012 dhe çmimi sipas kontratës së shitblerjes në shumën 11,210,000 lekë ishte paguar plotësisht. Ndërkohë, kontrata e kredisë është lidhur më vonë, në datën 27.3.2012 dhe në vijim, në datën 30.3.2012 është disbursuar kredia në shumën 3,452,000 lekë për t'iu kaluar prindërve të subjektit në datën 3.4.2012.

b.12. Trupi gjykues vlerëson se, veprimet e njëpasnjëshme të subjektit me përmbajtje fiktiviteti nuk i përshtaten aspak figurës së një magjistrati, të cilit ligji i ka dhënë të gjitha garancitë e nevojshme për krijimin tek publiku të modelit të një drejtësie të paprekshme.

c) Në lidhje me përdorimin nga subjekti të interesave të përfituara nga investimi i fondit të kredisë së marrë nga BKT-ja nga prindërit e saj, për të ripaguar interesat e kësaj

³³ Kthim përgjigjeje EKB-ja, me nr. *** prot., datë 26.2.2021.

³⁴ Sipas pikës 10 të kësaj VKM-je.

³⁵ Ministria kompetente për strehimin, sipas nenit 19 të ligjit nr. 9232/2004.

³⁶ Referuar përcaktimit në nenin 5 të kontratës së kredisë datë 27.3.2012.

kredie gjatë viteve, si dhe mosdeklarimin në deklaratat e pasurisë si të ardhura të dhuruara nga prindërit, sipas nenit 4 pika “f” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar

c.1. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e saj, ka konfirmuar faktin e pagimit të kësteve të kredisë nga prindërit e saj, për arsye të qëndrimit të prindërve në shtëpinë e saj e duke e konsideruar pagesën e kredisë si një formë kompensimi për qiranë, të cilën do të mund të paguanin prindërit për shkak të qëndrimit në këtë shtëpi. Nën këtë skemë mirëkuptimi midis saj dhe prindërve të saj, subjekti ka pretenduar se pagesa e kredisë nga prindërit nuk është dhurim, por është trajtuar *“si shumë kompensuese për mënyrën e jetesës së njëjës prej familjeve tona nën skemën e qirasë”*. Prandaj, në këtë kuptim, ka kërkuar zbritjen e shpenzimeve të qirasë në analizën financiare deri në shumën 665,000 lekë, për arsye se, sipas subjektit, paraqiten si shpenzime të dubluara.

c.2. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë të bazuara në fakte dhe prova dhe prandaj nuk duhen pranuar, për arsye se: i) nga analiza e ligjit nr.9232/2004, sipas të cilit subjekti përfitoi kredinë lehtësuese për strehim në banesë me kosto të ulët, subjekti nuk mund ta lëshonte banesën me qira gjate periudhës së shlyerjes së kredisë, pasi ishte në kushte ndaluese, sipas nenit 20 të këtij ligji, i cili parashikon se *“Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët, nuk mund t'i kalojë të drejtat që ajo ka mbi këtë banesë te një person tjetër, apo ta lëshojë atë me qira gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë”*; ii) në lidhje me shpenzimet për apartamentin e marrë me qira nga subjekti, trupi gjykues thekson se subjekti i ka vetëdeklaruar shpenzimet e qirasë në deklaratën e rivlerësimit kalimtar mbështetur në kontratën e qirasë nr *** rep., nr *** kol., datë 11.2.2014 dhe se janë konsideruar në analizën financiare sipas deklaramit të subjektit.

c.3. Trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka deklaruar në asnjë deklaratë periodike dhe as në “Vetting”, interesat e kredisë të paguara nga prindërit e saj dhe as marrëveshjen që pretendon ta ketë pasur me prindërit e saj për efekt të kompensimit të shpenzimeve të qirasë. Për trupin gjykues, ky është një pretendim i deklaruar për herë të parë nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe nuk provon të kundërtën e konstatimit të Komisionit për mosdeklarimin nga subjekti të dhurimeve të shumave të lekëve nga prindërit e saj për efekt të pagimit të kredisë.

c.4. Pretendimi i subjektit mbi dublimin e shpenzimeve nuk qëndron, pasi në analizën financiare të Komisionit shpenzimet e kredisë janë përlllogaritur sipas dokumentacionit bankar në zërin “Shpenzime për këstin e kredisë pranë Bankës BKT”, ndërsa shumat e kredituara nga prindërit për efekt të pagesës së kredisë janë përlllogaritur përkatësisht në zërin “Të ardhura të tjera ndihmë nga babai H. Ll.”.

c.5. Për rrjedhojë, trupi gjykues konkludon se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit të kryer nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për të deklaruar në deklaratat periodike 2012-2016, si dhe deklaratën “Vetting” të ardhurat e dhuruara nga prindërit, sipas nenit 4³⁷ pika “f” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, ku parashikohet se subjektet detyrohen të deklarojnë dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale.

d) Në lidhje me vlerësimin e rrethanave të përfshirjes së subjektit në hetimin e çështjes procedim penal nr. * ndaj disa zyrtarëve të lartë të Bashkisë Fier, në kuptim të nenit**

³⁷ Shtuar me ligjin nr. 85/2012.

26 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar

d.1. Në shpjegimet përfundimtare, subjekti ka deklaruar se nuk ka qenë në kushtet e heqjes dorë në lidhje me trajtimin e kallëzimit nr. ***, sipas nenit 17 pika 1, germa “ë” të K.Pr.Penale, “kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie”, pasi sipas saj, në atë kohë, nuk ishte në kushtet e pritjes së ndonjë vendimmarrjeje në favorin e saj nga Këshilli Bashkiak Fier. Gjithashtu, sipas subjektit, struktura e Task-Forcës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, ku ajo bënte pjesë, ka qenë vetëm me 3 prokurorë dhe kallëzimi i datës 16.7.2012 i është caktuar nga drejtuesi i Prokurorisë, urdhrin e të cilit ishte e detyruar ta zbatonte, në bazë të nenit 24, pikat 4 dhe 5 të K.Pr.Penale.

d.2. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit dhe pasi vlerësoi faktet dhe rrethanat, bazuar në legjislacionin në fuqi, vlerëson se subjekti ka qenë në kushtet e heqjes dorë nga hetimi i kallëzimit penal nr. ***, datë 16.7.2012, të paraqitur nga 15 qytetarë fierakë ndaj disa zyrtarëve të lartë të Bashkisë Fier për shpërdorim detyre dhe falsifikim të dokumenteve në shpërndarjen e banesave për strehim pa plotësuar kushtet, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur “mosfillimin e procedimit penal” me vendimin e datës 30.7.2012.

d.3. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion, pa ndaluar në vlerësimin e vendimmarrjes së subjektit, në kuptim të kriterit të aftësive profesionale, por vetëm duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e përdorimit të kredisë me kushte lehtësuese: i) për blerje pasurie jashtë juridiksionit territorial të Bashkisë Fier, për sa u provua nga hetimi se subjekti pas përfitimit të kredisë, bleu apartament në Tiranë kundrejt një çmimi shumëfish më të lartë dhe jo banesë me kosto të ulët, e cila duhej të përzgjidhej nga Bashkia Fier, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 9232/2004 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; ii) jo për qëllime strehimi, për sa u provua nga hetimi se subjekti nuk e përdori apartamentin, por mori me qira një tjetër banesë.

d.4. Këto rrethana për trupin gjykues konsiderohen të mjaftueshme për të krijuar dyshimin e arsyeshëm se subjekti ka pasur gjithë garancitë e mundshme nga Bashkia Fier për gëzimin dhe përdorimin e kredisë jo sipas destinacionit të dhënë.

d.5. Nën dritën e këtyre fakteve të provuara, trupi gjykues vlerëson se subjekti ishte në rrethanat e një konflikti midis interesit privat me atë publik, për shkak të trajtimit të kallëzimit të paraqitur nga 15 qytetarë fierakë ndaj disa zyrtarëve të lartë të Bashkisë Fier. Për të balancuar këto interesa, në kuptim të krijimit të garancive ligjore për zgjidhjen e drejtë dhe të paanshme të fakteve të paraqitura për zgjidhje, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, subjekti duhet t’i kishte paraqitur dorëheqjen drejtuesit të Prokurorisë, për shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, bazuar në nenin 26 dhe 17 pika 1, germa “ë” të Kodit të Procedurës Penale.

d.6. Normimi i situatave të tilla, me qëllim parandalimin e pasojave të padëshiruara, të cilat cenojnë besimin e publikut në institucionet e drejtësisë është objekt i një sërë rregullave me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar.

d.7. Më konkretisht, ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1 parashikon se “*Konflikti i interesit, është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike*”.

d.8. Parimet e Bangalores për sjelljen gjyqësore, të cilat zbatohen edhe për prokurorët³⁸ parashikojnë rregullime mbi vlerat e magjistratëve gjatë ushtrimit të detyrës, me qëllim krijimin

³⁸ Shih vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 10/2021 (JR), datë 24.3.2021

e besimit të publikut³⁹. Paanësia e një magjistrati është esenciale për ushtrimin e detyrës. Ajo gjen zbatim jo vetëm në vendimmarrje, por edhe në procesin që paraprind atë. Perceptimi i mungesës së paanësisë gërryen besimin e publikut⁴⁰.

d.9. Paanësia e një magjistrati, në kuptim të krijimit të besimit tek publiku, matet me anë testit subjektiv, i cili kryhet mbi bazën e bindjes personale në lidhje me rastin që paraqitet, si dhe testit objektiv që përfaqëson garancitë e mjaftueshme, që duhet të ofrojë magjistrati për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në lidhje me çështjen⁴¹.

d.10. Pretendimi i subjektit se çështja ishte caktuar nga drejtuesi i Prokurorisë dhe se ishte e detyruar ta zbatonte në bazë të nenit 24, pikat 4 dhe 5 të Kodit të Procedurës Penale, nuk qëndron, për arsye se kjo dispozitë rregullon ushtrimin e funksioneve të prokurorit dhe nuk prevalon mbi dispozitën detyruese, e cila rregullon heqjen dorë të prokurorit për arsye njëanësie, sipas nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale. Bazuar në këtë dispozitë, subjekti kishte mundësinë t'i paraqiste kërkesën për dorëheqje drejtuesit të prokurorisë, i cili do të mund të vendoste në lidhje me dorëheqjen apo jo të subjektit nga hetimi i çështjes. Për këto arsye, subjekti dështoi të provonte se ndërmori të gjitha masat nëpërmjet vënies në lëvizje të këtyre mjeteve ligjore për rregullimin e heqjes dorë nga çështja.

d.11. Bazuar në faktet dhe provat e rezultuara nga hetimi, shpjegimet e subjektit, si dhe pas kryerjes së analizës ligjore, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti ishte në kushtet e konfliktit të interesit e për rrjedhojë, duhet të hiqte dorë nga hetimi i procedimit penal nr. 1079/2012, sipas nenit 26 dhe 17 pika “ë” të K.Pr.Penale.

41.1. Si konkluzion në lidhje me vlerësimin në tërësi të veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti ndërmori një sërë veprimesh fiktive me qëllim përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, përdori shkaqe të paligjshme në hartimin e kontratave, shfrytëzoi politikat sociale strehuese të zbatuara nga Bashkia Fier për qytetarët e saj të pastrehë, për të blerë apartament në Tiranë, kundrejt një vlerë shumëfish më të lartë sesa ajo e përcaktuar për banesat me kosto të ulët, nuk e përdori apartamentin për strehim, por lejoi prindërit të banonin në të, mori pjesë në hetimin e një çështjeje me Bashkinë Fier në kushtet e konfliktit të interesit.

41.2. Trupi gjykues çmon se të gjitha këto veprime, nuk përputhen me sjelljen etike të një magjistrati, i cili duhet të shfaqë integritet të lartë, si gjatë ushtrimit të detyrës të saj, ashtu edhe jashtë veprimtarisë hetimore, duke marrë në konsideratë autoritetin dhe reputacionin që subjekti i rivlerësimit përfaqëson.

41.3. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programeve të trjanimit në kuptim të këtij neni, pasi me veprimet dhe mosveprimet e saj ka cenuar integritetin dhe autoritetin e organeve të drejtësisë.

42. Në lidhje me pasurinë shtesë anësore me sip. 18,1 m² (ballkon), pjesë e pandarë e apartamentit prej 59 m², trajtuar më lart, në pronësi të subjektit.

42.1. Gjatë hetimit⁴² të Komisionit rezultoi se subjekti ka të regjistruar në pronësinë e saj pasurinë me nr. *** ND, vol. ***, fq. ***, z.k. ***, lloji i pasurisë “ndërtesë”, me sipërfaqe 18.1 m², vol. ***, fq. ***, z.k. ***, në datën 19.5.2017.

³⁹ Vlera nr. 2 dhe nënpjesët e saj.

⁴⁰ Paragrafi 55 i Komentarit mbi Parimet e Bangalores për sjelljen gjyqësore: https://www.unodc.org/documents/nigeria/publications/Otherpublications/Commentry_on_the_Bangalore_p_rin_ciples_of_Judicial_Conduct.pdf.

⁴¹ Shih vendimin e GJEDNJ-së, *Wettstein vs Switzerland*, nr. 33958/96/42, ECHR2000-XII; vendimin e GJEDNJ-së, *Petur Thor Sigurdsson vs Iceland*, no. 39731/98 ECHR 10/07/2003.

⁴² Kthim përgjigjeje nr. ***, datë 3.10.2019; kthim përgjigjeje nr. ***, datë 11.6.2020.

42.2. Pasuria dhe të drejtat reale mbi të nuk janë deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2017.

Faktet nga hetimi administrativ

43. Në datën 10.11.2006, babai i subjektit, z. H. Ll., ka vetëdeklaruar si objekt për legalizim një shtesë ballkoni me adresë: pallatet “****”, shkalla ***, ap. *** (me sip. ndërtimi 16 m²).

43.1. Në datën 30.8.2016, prindërit e subjektit, kanë lëshuar një deklaratë noteriale⁴³ në të cilën kanë deklaruar se kanë lidhur kontratën e shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012 me vajzën e tyre Alketa Zifla (Ll.), për apartamentin 59 m², kundrejt shumës 3,452,000 lekë, për të cilën shprehin dakordësinë që të regjistrohet në emër të vajzës Alketa Zifla (Ll.). Në vijim, Drejtoria e Legalizimeve, pasi ka kryer procedurat e verifikimit të dokumentacionit dhe në terren, ka lëshuar lejen⁴⁴ e legalizimit nr. ***, datë 24.2.2017, në emër të Alketa H. Zifla, për pasurinë nr ***, sipërfaqe 18.1 m², z.k. ***, me adresë: pallatet “****”, Njësia Bashkiake nr. ***, Qarku Tiranë.

43.2. Pas hetimit administrativ të Komisionit, sqarimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi e provuar se ndërtimi i ballkonit është kryer nga babai i subjektit me shpenzimet e veta në vitet 1995-1996, sipas kërkesës për leje ndërtimi të datës 9.11.1995. Gjithashtu, duke konsideruar faktin se subjekti ka qenë studente në atë periudhë, trupi gjykues krijoi bindjen se ajo nuk ka pasur kontribut në ndërtimin e kësaj shtese.

43.3. Trupi gjykues, pas konstatimit se subjekti nuk e kishte deklaruar këtë shtesë në asnjë prej deklaratave periodike, kërkoi nga subjekti shpjegime, në përgjigje të të cilave deklaroi se, duke e vlerësuar ballkonin si pjesë integrale e apartamentit, përfshirë edhe çmimin e shitjes, ka vlerësuar se nuk duhej pasqyruar në DPV-të përkatëse.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

44. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit, vlerëson se subjekti ka pasur detyrimin të deklarojë në deklaratën periodike të vitit 2017 shtesën 18 m² ballkon, si ndryshimin në pasuritë e saj. Gjithashtu, çmon se mosdeklarimi përbën pasaktësi, e cila në bazë të parimit të proporcionalitetit nuk sjell penalizim, duke qenë se pasuria figuron e deklaruar dhe e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

45. Apartament banimi, me sip. 44 m², ndodhur në Tepelenë, *, pall nr. ***, ap. ***.**

45.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: me vendim të Këshillit të Bashkisë Tepelenë, viti 1995, sipas kontratës me këste me kusht me Entin Kombëtar të Banesave, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.5.2006, me afat 14 vite, këst 1.200 lekë në muaj (Raiffeisen Bank). Vlera **202.628 lekë**. Zotëron 50%. Këto të dhëna janë deklaruar edhe në seksionin “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të deklaratës “Vetting”.

45.2. Rezulton nga hetimi se në deklarinimin fillestar të pasurisë të vitit 2003 subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri. Në DPV/2004, ka deklaruar apartament banimi me sip. 82 m², pronë e Entit Kombëtar të Banesave, e pahipotekuar, ndodhur në lagjen “****”, pallati ***. Vlera afërsisht 400,000 lekë; pjesa që zotëron 50%. Ndërsa në DPV-të 2008-2010 ka deklaruar se apartamenti është marrë me vendimin e Këshillit Bashkiak Tepelenë, përmes kredisë së datës 25.5.2006 me Entin Kombëtar të Banesave, me këst mujor 1200 lekë, me afat 14 vite, duke pasqyruar edhe pagesat e shlyerjes së kredisë në “Raiffeisen Bank”. Në DPV/2011 e vijues deri në 2017, subjekti ka deklaruar në seksionin e detyrimeve financiare kredinë e marrë nga EKB-ja, shlyerjen e detyrimit dhe mbetjen deri në datën 31 dhjetor të vitit të deklarimit⁴⁵.

⁴³Deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol.

⁴⁴Leja e legalizimit bashkëlidhur në shkresën kthim përgjigjeje të ASHK-së Tiranë, nr. *** prot., datë 11.6.2020.

⁴⁵ Shih dosjen e hetimit administrativ.

Faktet nga hetimi administrativ

46. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se ka përfituar apartamentin me vendim të Këshillit të Bashkisë Tepelenë, sipas kontratës me këste me kusht, me Entin Kombëtar të Banesave, nr. *** rep., *** kol., datë 25.5.2006, si dhe ka depozituar si dokumentacion shoqërues⁴⁶.

46.1. Nga hetimi i Komisionit⁴⁷ nuk rezultoi e regjistruar në regjistrat publikë pasuria në emër të subjektit apo të personit të lidhur me të. Në pyetësin e parë, subjekti ka deklaruar se *kjo pasuri figuron e paregjistruar në ZRPP, pasi do të regjistrohej vetëm pas plotësimit të kushtit të pagesës së plotë të saj....*”

46.2. E pyetur⁴⁸ nga Komisioni për mënyrën e përfitimit të pasurisë, çmimin e blerjes, si dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e saj, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar ndër të tjera se apartamenti është përfituar me vendim nr. ***, datë 27.6.1995 të Këshillit Bashkiak Tepelenë, nga ish-bashkëshorti z. M. Z. dhe i ati E. Z., duke u marrë në dorëzim pa pagesë. Enti Kombëtar i Banesave, për pjesën takuese të ish- bashkëshortit, me sipërfaqe të shfrytëzueshme 38,61 m², pas më shumë se 10 vitesh, ka lidhur kontratën e shitjes me këste me kusht nr. *** rep., nr *** kol., datë 25.5.2006. Për të provuar deklarin e saj, subjekti ka bashkëlidhur dokumentacionin përkatës, si dhe kontratën e shitjes me këste me kusht nr. *** rep., nr *** kol., datë 25.5.2006 me përfitues M. Z. dhe E. Z. Gjithashtu, subjekti ka bashkëlidhur kontratë shitje me këste me kusht nr *** rep., nr ***, kol., datë 25.5.2006 e lidhur midis Entit Kombëtar të Banesave dhe D. Z., për apartamentin 32,39 m², si dhe dhe mandarkëtimet për shlyerjen e detyrimeve për banesën ***, ap. ***, ndodhur në Tepelenë.

Analizë ligjore mbi përfitimin e kësaj pasurie

47. Me vendimin e Këshillit Bashkiak Tepelenë nr. ***, datë 27.6.1995 “Për strehimin e shtetasve”, është vendosur akordimi i një apartamenti me nr. ***, banesa ***, ***, në favor të E. dhe M. Z.

47.1. Në datën 25.5.2006 është lidhur kontrata e shitjes me këste me kusht nr. *** rep., nr *** kol., midis Entit Kombëtar të Banesave Gjirokastër dhe ish-bashkëshortit të subjektit, për shitjen e apartamentit të banimit me sipërfaqe shfrytëzimi 38.61 m² dhe pjesa tjetër e përbashkët kundrejt vlerës 644,100 lekë, vlerë e cila pas zbritjeve, të përfituara për shkak të statusit si i pastrehë, sipas ligjit nr. 8647/2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8030 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, ka arritur në shumën 202.628 lekë, si detyrim i mbetur ndaj EKB-së. Nga hetimi rezultoi se huaja është paguar sipas kësteve të kontratës.

47.2. Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, ka rezultuar gjithashtu se në datën 25.5.2006 është lidhur kontrata e shitjes me këste me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., midis EKB-së Gjirokastër dhe znj. D. Z. për shitjen e apartamentit të banimit me sipërfaqe shfrytëzimi 38.39 m² dhe pjesa tjetër e përbashkët, kundrejt vlerës 540,336 lekë. Referuar mandateve bankare, të paraqitura nga subjekti, rezulton se znj. D. Z. ka paguar këstet mujore të kredisë për muajin maj dhe qershor 2006 për apartamentin e blerë prej saj.

47.3. Në përfundim të hetimit dhe vlerësimit të shpjegimeve, si dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, rezultoi se pasuria është përfituar nga ish - bashkëshorti dhe familjarët e tij në kohën kur subjekti ka qenë e martuar, sipas ligjit nr. 9416, datë 20.5.2005, “Për

⁴⁶Aneksi *** dosja e ILDKPKI-së fq. 73-74, dokumentacioni (i) vërtetim datë 26.1.2017 të EKB-së Gjirokastër, me përmbajtje “...M. Z. më 25.5.2006 ka lidhur kontratë shitjeje me këste, me kusht nr. *** rep., nr *** kol., me Entin Kombëtar të Banesave, Drejtoria Rajonale Gjirokastër, sipas kontratës çmimi i apartamentit është 202,628 lekë, shlyerja do të bëhet me këste mujore, me një afat kohor prej 14 vjet, me interes 3% në vit..” dhe (ii) plan vendosje e objektit banesa nr. ***, Fushë Tepelenë.

⁴⁷Shkresa nr. *** prot., datë 4.10.2019.

⁴⁸Pyetësin nr. 2.

procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fonde shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave”. Ndarja e apartamentit është bërë: sipërfaqja prej 38,61 m² e në favor të ish-bashkëshortit me kontratën e shitjes me këste me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.5.2006 kundrejt vlerës totale 202.628, me plan pagese me këste mujore në vlerën 1,200 lekë për një afat 14-vjeçar. Ndërsa pjesa tjetër e apartamentit me sipërfaqe shfrytëzimi 38.39 m² u është kaluar prindërve të ish-bashkëshortit, sipas kontratës e shitjes me këste me kusht nr. *** rep., nr *** kol., midis EKB-së Gjirokastrë dhe znj. D. Z.

47.4. Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti për mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën fillestare, e cila ka argumentuar se shkak ka qenë moskuptimi i saj, gjë që është korrigjuar në DPV-të pasardhëse. Subjekti ka theksuar se, fakti që nuk ka pasur qëllim fshehjen e saj, vërtetohet edhe me deklarimin e kësaj pasurie si adresë banimi po në këtë deklaratë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

48. Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të subjektit, si dhe pas analizës ligjore, çmon se pasaktësia në deklarimin për herë të parë nga subjekti, nuk mbart një peshë të tillë që të çojë në zbatimin e ndonjë mase disiplinore, për sa kohë është deklaruar si adresë banimi dhe në deklaratat vijuese është pasqyruar si pasuri e fituar nga Enti Kombëtar i Banesave dhe detyrimet e mbetura ndaj tij.

49. Apartament i marrë me qira, me sipërfaqe 61,8 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, zona kadastrale ***, me adresë: blv “****”, pallatet “****”, shk. ***, k. ***, ap. ***, sipas kontratës së qirasë nr. *** rep., *** kol., datë 11.1.2014, afat 2-vjeçar e rinovuar, me 25,000 lekë/muaj.

49.1. Pas administrimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti⁴⁹dhe verifikimit të deklaramëve rezultoi se subjekti ka lidhur kontratë qiraje për pasurinë e mësipërme me z. K.H., i cili e ka fituar pronësinë kontratën e shitblerjes me nr. *** rep., dhe *** kol., datë 20.11.2003.

49.2. Gjatë hetimit administrativ, u konstatua se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e vitit 2014 të drejtat reale (përdorimit, gëzimit) mbi këtë pasuri dhe as mbi pasurinë “apartament” të marrë me qira në Fier, sipas kontratës së qirasë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.12.2008, paraqitur si provë nga subjekti për të provuar shpenzimet e mobilimit për apartamentin e marrë me qira në Tiranë.

49.3. Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua e drejta për të paraqitur shpjegime mbi mosdeklarimin e të drejtave reale për pasuritë e marra me qira në deklaratat vjetore, përkatësisht në vitin 2008 për banesën e marrë me qira në Fier dhe në vitin 2014 për apartamentin e marrë me qira në Tiranë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

50. Subjekti ka pranuar pasaktësitë e deklarimit dhe ka sqaruar se parregullsia është korrigjuar në deklaratën “Vetting” ku e ka deklaruar apartamentin në Tiranë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

51. Trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi në deklaratat periodike i të drejtave reale mbi pasuritë e marrë me qira përbën pasaktësi, por jo e tillë për zbatimin e një mase disiplinore, meqenëse subjekti e ka korrigjuar në deklaratën “Vetting”, si dhe ka paraqitur dokumentacion provues.

52. Pasuria e llojit “depozitë” në vlerën 50,000 lekë pranë “Credins Bank”, në emër të R. Z. dhe Alketa Zifla, sipas kontratës së depozitës “****” datë 5.10.2016.

⁴⁹Në përgjigje të pyetsorit të dytë.

52.1. Nga verifikimi i deklaratës “Vetting”, u konstatua se subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit për këtë pasuri.

52.2. Në deklaratën periodike të vitit 2016 subjekti e ka deklaruar këtë pasuri “...*Depozitë në “Credins Bank”, në emër të R. Z. dhe Alketa Zifla sipas kontratës së depozitës “***”⁵⁰ datë 5.10.2016 me cilësinë e kujdestarit të depozitës...*”, por edhe në këtë deklaratë vihet re se subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të depozitës.

Analiza e fakteve për këtë pasuri

53. Nga hetimi i Komisionit⁵¹ ka rezultuar se në llogarinë e personit të lidhur R. Z. pranë “Credins Bank”, në datën 5.10.2016 janë depozituar 50,000 lekë nga znj. L. Ll.

53.1. Nga vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ISSH-ja në lidhje me të ardhurat e znj. L. Ll. ⁵² rezulton se ajo ka përfutuar pension pleqërie nga viti 1993 e në vijim me masë aktuale 19,809 lekë/muaj. Pra, rezulton se për vitin 2016 të ardhurat e znj.L. Ll. kanë qenë në shumën rreth 198,000 lekë dhe se shuma e dhuruar mbesës së saj përfaqëson 25% e totalit të të ardhurave.

53.2. Në përfundim, pas analizës së kryer rezultoi se personi tjetër i lidhur me subjektin znj.L.Ll.ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e depozitës në shumën 50.000 lekë në favor të mbesës së saj R. Z.

53.3. Subjektit iu kërkuan shpjegime për mosdeklarimin e burimit të krijimit të depozitës në DPV-në e vitit 2016, si dhe në deklaratën “Vetting”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

54. Subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar se *mosdeklarimi i burimit të krijimit (kursime të nënës) ka qenë një pakujdesi e saj, edhe pse këto vlera monetare janë shuma të depozituara në bankë dhe lehtësisht të vërtetueshme dhe transparente nga çdo institucion shtetëror me tagra verifikuese.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

55. Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të subjektit, vlerëson se subjekti ka pasur detyrimin të deklarojë në deklaratën e rivlerësimit kalimtar burimin e krijimit për pasurinë depozitë në vlerën 50,000 lekë, por mosdeklarimi nga ana e subjektit nuk e penalizon atë në kuptim të nenit 61 pika 3 e ligjit 84/2016 në bazë të parimit të proporcionalitetit, për sa nga hetimi u identifikua burimi i krijimit të depozitës si dhe mjaftueshmëria financiare për krijimin e depozitës me burime të ligjshme, sipas nenit D pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

Personat e lidhur

56. Pasuri e llojit “llogari kursimi” në vlerën 188,724 lekë, pranë BKT-së në emër të K. Z.

56.1. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: K. Z. ka deklaruar në DPV/2016: “...*Llogari kursimi në BKT në emër të K. Z. nr. ***, gjendja deri më 31.12.2016...*”

Hetimi/analiza i/e kryer nga Komisioni për këtë pasuri

57. Nga hetimi i Komisionit⁵³, ka rezultuar se në llogarinë e kursimit të personit të lidhur K.Z. pranë BKT, është depozituar *cash* shuma 170,000 në datën 12.4.2016 dhe 18,400 lekë në datën 13.10.2016 me gjendje **188,724** lekë në datën 31.12.2016.

⁵⁰ Subjekti ka bashkëlidhur në deklaratën “Vetting” kontratën e depozitës “***”, datë 5.10.2016, në “Credins Bank”, në emër të R. Z. dhe Alketa Zifla, të shumës 50.000 lekë, me afat maturimi 8- vjeçar.

⁵¹ Kthim përgjigjeje nga “Credins Bank” nr. *** prot., datë 4.11.2019.

⁵² Kthim përgjigjeje nga ISSH-ja nr. *** prot., datë 11.5.2020.

⁵³Shkresa kthim përgjigjeje nr *** prot datë 27.09.2019 nga BKT Bank.

57.1. Komisioni konstatoi mungesën e deklaratimit të burimit të krijimit të këtyre fondeve në deklaratën periodike të vitit 2016 dhe në deklaratën “Vetting”, në seksionin e dedikuar për personat e lidhur me subjektin. Pasi iu kërkuan shpjegime, subjekti ka deklaruar se burimi i këtyre fondeve ka qenë tërheqja e depozitës së djalit K. Z. pranë “Raiffeisen Bank” me të cilat është hapur llogaria e kursimit pranë BKT-së. Diferenca e vogël e vlerave financiare midis tyre është rrjedhojë e veprimeve në derdhje në llogari në fund të vitit 2016, me të ardhura nga kursimet e mbledhura nga dhuratat e familjarëve për djalin, K. Z. Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion provues⁵⁴.

57.2. Pas verifikimit⁵⁵ subjektit iu kërkuan shpjegime për mosdeklarimin e burimit të krijimit në DPV/2016 të depozitës në B*** dhe në DPV/2009 për depozitën në “Raiffeisen Bank” për fëmijën e mitur në atë kohë, K. Z. Në përgjigjen e saj, subjekti ka sqaruar se shkak i rrjedh nga pakujdesia, por shumat janë lehtësisht të vërtetueshme, ndërsa në lidhje me depozitën në “Raiffeisen Bank” ka deklaruar se është mjaftuar me bashkëlidhjen e pasqyrave të llogarisë në DPV/2009. Për më tepër kjo depozitë është deklaruar edhe në DPV/2012.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

58. Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të subjektit dhe verifikimeve, konstaton se mungon deklarimi i depozitës në deklaratën e vitit 2009, sikundërse pretendon subjekti, ndërkohë çmon se deklarimi i kësaj depozite në vitin 2012 përbën pasaktësi në bazë të nenit 4, pika 1, germa “d” e ligjit nr. 9049/2003. Trupi gjykues vlerëson se kjo pasaktësi nuk është e tillë, që do të sillte marrjen e një mase disiplinore ndaj subjektit, duke qenë se në deklaratën e vitit 2012 rezulton deklarimi në formën e shtesës së likuideteve të kësaj depozite.

58.1. Trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim edhe në lidhje me mosdeklarimin në DPV/2016 të burimit të krijimit të depozitës në BKT dhe si përfundim, në bazë të parimit të proporcionalitetit, vlerëson se pasaktësitë në mosdeklarim nga subjekti, nuk janë të tilla për marrjen e një mase disiplinore, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga deklaratimet e subjektit dhe hetimi administrativ u konfirmua burimi i krijimit të tyre.

Mbi llogaritë bankare të personave të lidhur

59. Komisioni konstaton se pas verifikimeve në lidhje me llogaritë rrjedhëse bankare të personit të lidhur K. Z. në “Raiffeisen Bank” dhe “Fibank”, si dhe llogarisë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” të E. Z., nuk rezultuan problematika.

Çështje të tjera

60. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti ka deklaruar në DPV/2004 (në seksionin e të dhënave konfidenciale) **objekt, magazinë + tokë truall të tij, me sipërfaqe 185, 2 m², nr. *** regj., datë 9.10.2000, Zyra e Regjistrimit Tepelenë**, por nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën “Vetting”.

60.1 Nga ZVRPP-ja Tepelenë⁵⁶ konfirmohet se në emër të shtetasit M. H. Z., figuron e regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, z.k. ***, qyteti Tepelenë, njësi me sipërfaqe 185.2 m².

Mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie

⁵⁴ Kontratë depozite “****”, datë 6.5.2009 dhe librezja e saj; kontratë e lidhur mes BKT-së dhe K. Z. datë 12.4.2016; kontratë e lidhur mes BKT-së dhe K. Z., datë 12.4.2016; mandat për derdhjen e lekëve në depozitën BKT, datë 12.4.2016; statement i lëvizjeve në llogarinë BKT për vitin 2016 (2 fletë).

⁵⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 17.9.2019, “Raiffeisen Bank”.

⁵⁶ Komunikim elektronik me e-mailin datë 27.11.2018, midis ILDKPKI-së dhe ZVRPP-së Tepelenë, Aneksi ***, fq. ***. Kartelë e pasurisë së paluajtshme; kontratë shitjeje nr. ***, datë 4.5.2004; vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 9.10.2000, në emër të P. K.

61. Në datën 4.5.2004 është lidhur kontrata e shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., midis P. K. dhe ish-bashkëshortit të subjektit me objekt shitjen e një magazine dykatëshe me sip. 370.4 m², me funksion magazinë e pjesëve të ndërrimit dhe helmeve të buta, si dhe tokë truall me sip. 92.6 m² që i përket magazinës, kundrejt vlerës 100.000 lekë.

Mbi burimin e krijimit

62. E pyetur⁵⁷ nga Komisioni mbi pagesën e çmimit të blerjes dhe burimin e krijimit të të ardhurave të kësaj pasurie, subjekti ka sqaruar se ajo është përfituar nga ish-bashkëshorti i saj në cilësinë e blerësit të me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.5.2004 në shumën 100,000 lekë. Paga është kryer sipas përcaktimeve të bëra në kontratë. Burimi i këtyre të ardhurave ka qenë paga ime si prokurore dhe paga e ish-bashkëshortit të saj si regjizor i Shtëpisë së Kulturës Tepelenë, pra, nga kursimet e e saj familjare.

Për të provuar këto deklarime, subjekti ka bashkëlidhur kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.5.2004.

62.1. Më poshtë paraqitet analiza financiare për vërtetimin e mundësisë financiare për blerjen e pasurisë në datën 4.5.2004.

Tabela nr.1.

Analiza financiare për blerjen e magazinës dhe truallit datë 4.5.2004	04.05.2004
A) PASURI	100,000
Objekt magazinë sip 185 m ² + truall, e blerë në datën 4.5.2004	100,000
Ndryshim likuiditeti	0
TOTAL LIKUIDITETE	0
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	100,000
D) TË ARDHURA	553,685
Të ardhura nga paga SR (1.1.2004 – 4.5.2004)	479,727
Të ardhura nga paga bashkëshorti	73,958
E) SHPENZIME	125,152
Shpenzime jetike	125,152
Analiza Financiare (D-C-E)	328,533

62.2. Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti dhe ish-bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi financiare për blerjen e magazinës në vitin 2004.

62.3. Në vijim, në kuadër të hetimit, është pyetur subjekti mbi investimet e mundshme të kryera mbi këtë pasuri apo të ardhurat të përfitura prej saj, e cila, ka sqaruar se nuk ka kryer asnjë shpenzim dhe nuk ka përfituar asnjë të ardhur nga pasuria, duke paraqitur në cilësinë e provës, midis të tjerave, edhe foto aktuale të objektit. Trupi gjykues i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit, nga të cilat nuk rezultuan indicie për hetime të mëtejshme.

⁵⁷Pyetësori nr. 2.

62.4. Në përfundim të hetimit për këtë pasuri, subjektit iu kërkuan shpjegime për mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”, e cila ka sqaruar se shkaku ka qenë keqkuptimi i deklaratës, pasi në vitin 2016 subjekti kishte zgjidhur martesën me ish-bashkëshortin dhe ndarja e pasurisë së përbashkët ishte bërë me marrëveshje midis tyre, sipas së cilës, secili do të administronte lirisht pasuritë e regjistruara në emrin e tij/saj.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

63. Trupi gjykues pas administrimit të shpjegimeve, vlerëson se subjekti ka pasur detyrimin e deklaramit të pjesës takuese në pasurinë e mësipërme, si pasuri e fituar gjatë martesës dhe se nga hetimi nuk rezultoi ndonjë marrëveshje midis ish-bashkëshortëve për ndarjen e pasurive të përbashkëta. Megjithatë, trupi gjykues vlerëson se qasja e subjektit për respektimin e ligjit për administrimin e pasurive të përbashkëta midis ish-bashkëshortëve, që ka sjellë si pasojë mosdeklarimin e pjesës së saj takuese në deklaratën “Vetting”, nuk mund të cilësohet si fshehje, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 dhe germës “c” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në DPV/2004.

64. Automjeti tip “AUDI 80” prodhimi i vitit 1984, i blerë në vitin 2000

64.1 Në DPV/2004, subjekti ka deklaruar autoveturë “Audi”, vit prodhimi 1982, blerë nga shtetasi italian N. C., sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22. 5.2000, për vlerën 300,000 lekë, ndërsa mungon deklarimi i saj në deklaratat vijuese dhe në “Vetting”.

64.2. Nga hetimi i Komisionit⁵⁸ nuk u konfirmua pasuria automjet tip “Audi”.

64.3. Subjekti, gjatë hetimit administrativ, ka sqaruar se ky automjet ka qenë me targë italiane, - me qëndrim të përkohshëm - dhe nuk ka qenë asnjëherë i regjistruar në DPSHTRR, pasi menjëherë pas blerjes ka pësuar defekt të rëndë. Në këto kushte është mbajtur dhe përdorur vetëm për pjesë këmbimi deri në asgjësimin e tij.

64.4. E pyetur nga Komisioni për burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar⁵⁹ se nga çmimi i përgjithshëm i blerjes, vlera 70,000 është mbuluar nga paga dhe kursimet e saj familjare, ndërsa shuma 230,000 lekë, përmes huamarrjes (60,000 drahmi) nga kushëriri i saj V. Ll., të realizuar nga imigracioni në Greqi. Huaja është shlyer pjesë-pjesë nga qershori i vitit 2000 deri në mesin e vitit 2003. Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion provues⁶⁰.

64.5. Zoti V. Ll. është person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 32 pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të huas së dhënë subjektit në shumën 60,000 drahmi. Në këtë kuptim, Komisioni kërkoi nga subjekti provueshmërinë me dokumentacion justifikues ligjor të burimit të krijimit për shumën e dhënë hua 60,000 drahmi.

64.6. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit⁶¹, vendosi në dispozicion të Komisionit deklarimet tatimore të të ardhura vjetore për vitin 2000, të z. V. Ll., në shumën 1,119,120 drahmi, të ardhura këto të mjaftueshme për mbulimin e shumës së dhënë hua ndaj subjektit të rivlerësimit.

64.7. Në përfundim të hetimit, subjektit iu kërkuan shpjegime për mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën para fillimit të detyrës, si dhe në lidhje me ndryshimet në deklaratat e tjera periodike vjetore. Subjekti ka deklaruar se shkaku i mosdeklarimit ka qenë kuptimi se në deklaratë duhet të shpreheshin vetëm pasurive të regjistruara dhe nuk është pasqyruar as në ndryshimin e pasurive në deklaratat e mëvonshme, duke qenë se mjeti nuk u regjistrua

⁵⁸Shkresa kthim përgjigje e DPSHTRR, nr *** prot., datë 12.05.2020.

⁵⁹Pyetësi nr. 2

⁶⁰ 1. kontratë shitje automjeti me palë shitëse N. C. dhe palë blerëse Alketa Zifla për mjetin “Audi 80” vit prodhimi 1984, çmimi 300,000 lekë; deklaratë të z. V. Ll. ku deklarohet se i ka dhënë hua subjektit shumën 60,000 drahmi në mars të vitit 2000; fotokopje pasaporte të V. Ll. me vlefshmëri 2000-2005; fotokopje të vizës greke datë 6.12.2003 dhe 6.12.2004; certifikatë pronësie në Itali për automjetin e N. C.; vërtetim hyrje mjeti në Shqipëri 12.5.2000.

⁶¹ Pyetësi nr. 2

asnjëherë dhe pjesët e tij u shitën për shuma të papërfillshme. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20. 5.2020 të lëshuar nga z. V. Ll.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

65. Trupi gjykues, në kuptim të nenit 6 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” vlerëson se subjekti ka pasur detyrimin e deklarinimit të kësaj pasurie në deklaratën para fillimit të detyrës për sa kohë e ka disponuar atë, si dhe në deklaratat vijuese pakësimin e pasurisë në momentin e shitjes.

65.1. Pretendimi i subjektit se pasuria nuk është deklaruar prej saj, pasi nuk ishte e regjistruar, nuk qëndron dhe është kontradiktor me vetë deklarinimin e kryer prej saj për këtë pasuri një vit më vonë, pra në deklaratën e vitit 2004, në rrethanat ku sipas deklarinimit të subjektit automjeti ka qenë i peregjistruar ndonjëherë në DPSHTRR.

65.2. Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i subjektit në deklaratën para fillimit të detyrës të pasurisë objekt kontrolli dhe në deklaratat pasuese në formën e pakësimit të pasurisë, përbën pakujdesi të subjektit dhe nuk mund të sjellë penalizimin e tij, në kuptim të nenit 61 pika 3, për sa subjekti e ka deklaruar pasurinë në deklaratën e vitit pasues dhe nuk ka pasur përpjekje për fshehjen e tij.

Personat e tjerë të lidhur

66. Gjatë hetimit administrativ, sikundër është trajtuar tek pasuria e parë, u konstatua lidhja e interesit pasuror të subjektit me prindërit e saj, në lidhje me pasurinë apartament 59 m²⁶², të cilët në kuptim të nenit 3 pika 14 e ligjit nr. 84/2016, konsiderohen persona të tjerë të lidhur me subjektin. Për shkak të kësaj lidhjeje, Komisioni kreu hetim në lidhje me z. H. Ll. (i ati) dhe L. Ll. (e ëma), në përfundim të të cilit ka rezultuar se:

66.1. Automjet “Skoda Yeti”, vit prodhimi 2011, targa *, vlera 7,200 euro, datë 7.6.2017 nga “***” sh.p.k, në pronësi të babait të subjektit**

66.1.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se, në datën 7.6.2017 është lidhur kontrata e shitjes midis “***” sh.p.k dhe babait të subjektit dhe DPSHTRR-ja⁶³ konfirmon regjistrimin e këtij mjeti në emër të z. H. Ll.

66.1.2. Në lidhje me këtë pasuri, subjekti ka deklaruar në pyetësorin e parë⁶⁴, ndër të tjera, se për nevoja pune apo familjare përdor pikërisht këtë autoveturë.

66.1.3. E pyetur nga Komisioni⁶⁵ për burimin e krijimit të kësaj pasurie nga babai i saj, subjekti ka deklaruar se të hollat janë siguruar nga vëllai i saj L. Ll., emigrant me nënshtetësi britanike, i cili punon dhe jeton në Angli prej vitit 1994. Një pjesë e këtyre të ardhurave në shumën 3,500 euro është siguruar nga shitja më 4.11.2016 e automjetit me targë *** në pronësi të vëllait dhe pjesa tjetër në shumën 3,700 euro nga kursimet e tij nga paga. Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues⁶⁶.

66.1.4. E pyetur nga Komisioni lidhur me mënyrën e transferimit të shumës 3,700 euro nga vëllai L. Ll. nga Anglia, subjekti ka pohuar se i vëllai vinte në Shqipëri pothuajse çdo vit që prej vitit 1994 dhe i sillte babait vlera monetare për shpenzime jetese apo investime të vogla, si në rastin konkret.

⁶² Për shkak të konstatimit të këtyre fakteve: qëndrimi në shtëpi i prindërve të subjektit pa pagesë, pagesa e kësteve të kredisë nga prindërit e subjektit.

⁶³ Shkresa kthim përgjigje e DPSHTRR-së *** prot., datë 12.5.2020.

⁶⁴ Pyetësori nr.2.

⁶⁵ Pyetësori nr. 3.

⁶⁶ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., *** kol., datë 4.11.2016; kontratë shitblerjeje, datë 7.6.2017 dhe dokumentet e pronësisë së mjetit; deklaratat vjetore të të ardhurave për L. Ll. për vitet 2015, 2016, 2017.

66.1.5. Nga verifikimi në sistemin TIMS konfirmohet hyrja e shtetasit L. Ll. në Shqipëri⁶⁷, e cila përkon me kohën e shitjes së automjetit me targë ***, sikurse deklarohet nga subjekti.

Analiza e burimeve të krijimit

67. Nga hetimi për burimin e krijimit të shumave 3,500 euro dhe 3,700 nga z. L. Ll., rezultoi se shuma e parë është përfituar nga shitja e automjetit të markës “Nissan”, me targa ***, sipas kontratës së shitblerjes⁶⁸ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.11.2016, ndërsa për shumën e dytë, sipas deklaratës vjetore⁶⁹ të tipit “****” për vitet 2015, 2016, 2017 rezulton se të ardhurat e z.Ll. kanë qenë në shumën 60,218 euro dhe shuma e dhënë babait në vlerën 3,700 euro përfaqëson sa 6% e totalit të të ardhurave të tij.

67.1. Në përfundim të hetimit, Komisioni nuk konstatoi indicie në interesa pasurorë të kësaj pasurie, përveçse të drejtave të përdorimit të deklaruara nga vetë subjekti.

68. Transaksionet në shumën 90,000 euro nga babai i subjektit për blerje apartamenti

68.1. Nga hetimi i Komisionit kanë rezultuar disa transaksione financiare me vlera të konsiderueshme të kryera nga babai i subjektit: i) transaksion i datës dt 20.10.2015 në “Union Bank”⁷⁰, depozitim në cash në shumën 30,000 euro me përshkrimin “...H. Ll. për A. R. pag kontratë sipërmarrje datë 16.3.2015 blerje apartamenti ...” ii) transaksione në datat 11.2.2016 dhe 6.5.2016 në “Union Bank”, në total në shumën 60,000 euro, përbërë nga dy depozitime në cash në shumat 30.000 euro secili me përshkrimet përkatëse “H. Ll. për A. H. R. pagesë kontratë sipërmarrje dt. 16.03.2015 blerje apart. kësti dytë” dhe H. Ll. për A. R. pag kontratë sipërmarrje datë 16.03.2015 blerje apartamenti kësti i dytë ...”.

68.2. Pasi është pyetur⁷¹ subjekti dhe i është kërkuar⁷² të provojë me dokumentacion provues burimet e krijimit në lidhje me to, në përgjigje ka sqaruar se transaksionet lidhen me vëllain tjetër të saj, z. K. Ll., i cili ka porositur nëpërmjet të të atit një apartament dhe garazh në Tiranë tek z. A. R., për të cilin ka rënë në dijeni pas dërgimit të pyetësorit nga Komisioni. Në këtë apartament qëndrojnë fëmijët e tij gjatë shkollimit. Apartamenti nuk është regjistruar në emër të tij pasi objekti nuk është regjistruar në Zyrën e Kadastrës Tiranë dhe se në lidhje me këtë apartament nuk është paguar ende kësti i fundit.

68.3. Si burim krijimi i të të ardhurave të vëllait për porositjen e kësaj pasurie ka shërbyer shitja e disa apartamenteve në “****” Vlorë, ku vëllai i saj ka qenë pronar trualli me sipërfaqe 500 m², të cilin ia ka dhënë me sipërmarrje një firme ndërtimi për një objekt banimi mbi 8-9 kate, ku në përfundim të të cilit ka përfituar 1 njësi, 8 apartamente dhe 2 garazhe. Në lidhje me këto deklarime, subjekti ka paraqitur dokumentacion provues⁷³.

68.4. Komisioni ka konstatuar se vëllai i subjektit të rivlerësimit z. K. Ll. është subjekt deklarues në ILDKPKI, për shkak të funksionit që mban. Më tej, Komisioni ka kërkuar⁷⁴

⁶⁷L. Ll. ka hyrë në datën 30.10.2016 në Shqipëri dhe ka dalë në datën 13.11.2016.

⁶⁸Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.11.2016 në fq. 33 të pyetësorit nr. 3.

⁶⁹Dokumentacion i paraqitur në përgjigje të pyetësorit nr. 3, fq. 59-63.

⁷⁰Shkresa kthim përgjigje nga “Union Bank” nr. *** prot., datë 15.5.2020.

⁷¹Pyetësi nr. 3.

⁷²Shih pyetësin nr. 4.

⁷³Tri mandatpagesa (20.10.2015; 11.2.2016; 6.5.2016); deklarata noteriale nr. repertori ***, nr. koleksioni ***, datë 13.11.2020 lëshuar nga K. Ll.; kontratë Sipërmarrje mes palëve (jonoteriale) datë 16.3.2015; vërtetim nga dokumentet hipotekorë nr. ***, datë 30.8.2007; kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.8.2007; dok. regjistrimi në ZVRPP mbi apartamentet, njësitë dhe garazhet në emër të “****” të lëshuara datë 6.12.2010; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.2.2011; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.12.2010; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.2.2011; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., *** kol., datë 18.2.2011; kontratë shitblerjeje nr.*** rep., nr. *** kol., datë 13.2.2012; kontratë këmbimi me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.12.2010.

⁷⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 30.4.2021.

deklarimet e z. Ll., ku pas verifikimit të tyre, nuk u konstatua në asnjë deklaratë deklarimi i porositjes së apartamentit nga ai.

68.5. Në përfundim të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 mbi dyshime të arsyeshme për fshehje pasurie, për sa rezultuan nga hetimi këto fakte: i) kontrata e sipërmarrjes rezultoi e lidhur nga babai i subjektit të rivlerësimit jo nga vëllai i saj, në mungesë të një prokure për të vepruar në emër dhe për llogari të tij; ii) nuk provohet pamundësia e vëllait të subjektit për nënshkrimin e kontratës; iii) z. K. Ll. nuk rezultoi të kishte deklaruar si subjekt deklarues në lidhje me porositjen e pasurive, sikurse kërkohet nga ligji nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive”; iv) nuk provohet burimi i krijimit të të ardhurave në shumën 90.000 euro nga vëllai i subjektit dhe as mënyra e dorëzimit të kësaj shume të konsiderueshme babait të subjektit; v) vëllai i subjektit kishte mundësi të kryente vetë pagesat nga qyteti i Vlorës nëpërmjet bankave të nivelit të dytë, vi) nuk provohet marrja në dorëzim, përdorimi i apartamentit në Tiranë dhe lidhja e shërbimeve utilitare për të.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

69. Subjekti ka sqaruar se vëllai i saj ka burime të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie të cilat provohen nga kontratat e shitblerjes së apartamenteve në Vlorë, nga qiratë e këtyre pasurive të paluajtshme të deklaruara në DPV nga ai, të ardhurat nga paga, të cilat në një analizë të plotë të treguesve financiarë prej vitit 2010, deri në momentin e kryerjes së këtyre pagesave të kësteve në vitet 2015 dhe 2016, vërtetojnë plotësisht ekzistencën e burimeve të ligjshme të vëllait z. K. Ll. për mbulimin e shumës prej 90.000 euro.

69.1. Subjekti për të provuar mbi barrën e provës së lënë për këtë pasuri, paraqiti në cilësinë e provave: i) foto të banesës, ku jeton me qira prej më shumë se shtatë vitesh; ii) ekstrakt nga DPT, listëpagesa e z. K. Ll., ku pasqyrohen të ardhurat për periudhën korrik 2012 – prill 2021; iii) vërtetim nga ISSH-ja për pagesën e kontributeve tatimore në emër të z. K. Ll., për periudhën korrik 2012 – prill 2021, gjeneruar nga sistemi elektronik me vulë digjitale; iv) deklaratë noteriale të administratorit të pallatit z. A. K. së bashku me akte që provojnë qenien e tij me këtë detyrë, në origjinal; v) deklaratë noteriale të subjektit ndërtues A. R., në origjinal; vi) certifikatë personale e E. dhe D. Ll., të dy fëmijë të z. K. Ll., printuar nga platforma e-Albania, me vulë elektronike; vii) vërtetime nga universiteti “***”, për E. dhe D.Ll. nga ku rezulton se E. Ll. është diplomuar dhe ka përfunduar pas gjashtë vitesh këtë universitet ndërsa D. është studente e vitit të katërt, të dy në degën Mjekësi, në formën e kërkuar sipas ligjit; viii) kontratë tip për administrimin e bashkëpronësisë, datë 27.7.2018, ku rezulton se E.Ll. është banor i atij pallati si dhe anëtar i kryesisë së pallatit; ix) kontrata të lidhura për shërbimin e internetit dhe pagesa të tyre ndërmjet “***” dhe z. E. Ll., në vite të ndryshme, prej vitit 2016 deri në 2020, ku pasqyrohet adresa e banimit e njëjtë me adresën e apartamentit⁷⁵; x) pagesa të shërbimeve utilitare, ujë dhe energji elektrike për banesën e përdorur prej tij nga z. E. Ll.; xi) porosi të ndryshme të kryera online nga z. E. Ll., ku duket adresa e apartamentit e njëjtë me adresën sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 16.3.2015.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

70. Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të subjektit bazuar në provat e paraqitura, vlerëson se ato janë bindëse. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti me prapësimet e rezultateve të hetimit, Komisioni vëren se djali dhe vajza e z. K. Ll. kanë qenë student në Tiranë, përkatësisht prej vitit 2014 dhe 2015. Djali i vëllait të subjektit ka qenë pjesëtar i asamblesë të banorëve të pallatit ku ndodhet apartamenti, ka lidhur disa kontrata për shërbime lidhje interneti dhe e ka përdorur adresën e apartamentit si adresë reference për disa porosi *online* të kryera prej tij.

⁷⁵ Rruga “***”, prapa UET-së.

70.1. Trupi gjykues, duke konsideruar faktet e porositjes së apartamentit dhe fillimin e studimeve nga fëmijët e z. K. Ll., i gjen të lidhura në kohë me njëra-tjetrën. Gjithashtu, kontratat e shërbimeve utilitare të lidhura nga i biri i z. K. Ll. janë indicie provuese për posedimin e këtij apartamenti nga fëmijët e z. K. Ll.

70.2. Si konkluzion, nga analizimi në tërësi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, rezulton se ka indicie provueshmërie të lidhjes së kësaj pasurie me z. K. Ll. dhe se nuk u provua, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, lidhja e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri.

Mbi disa transaksione (transferta hyrëse dhe dalëse) të kryera nga llogaria e babait të subjektit

71. Gjatë hetimit, Komisioni ka konstatuar disa transferta hyrëse dhe dalëse nga llogaritë e tij ndër vite në disa banka dhe institucione të tjera financiare, me persona të tretë.

71.1. Komisioni i ka hetuar këto transferta, si dhe ka pyetur⁷⁶ subjektin, në lidhje me marrëdhënien me këta shtetas, arsyen e kryerjes së këtyre transaksioneve si dhe burimin e krijimit të të ardhurave për kryerjen e transaksioneve të mbështetura në dokumentacion provues.

71.2. Subjekti ka sqaruar se ajo dhe familja e saj nuk kanë asnjë lidhje me këto transaksione e për rrjedhojë nuk lind e nevojshme justifikimi i burimit të këtyre të ardhurave. Ajo ka sqaruar se transaksionet janë kryer nga babai i saj si ndërmjetës për kryerjen e disa shërbimeve në favor të të afërmeve, të njohurve të tij (apo personave që kanë vepruar për llogari të tyre), në pamundësi për t'i kryer vetë ato, sipas asaj çfarë i ka shpjeguar i ati, duke dhënë sqarime gjithashtu edhe për marrëdhënien me ta dhe arsyen e kryerjes së transaksioneve. Për të provuar shpjegimet e saj, subjekti paraqiti disa prova⁷⁷.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

72. Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve shteruese të subjektit në lidhje me këto transaksione, analizës së provave të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe në vijim të rezultateve të hetimit, vlerëson se ato janë bindëse për të provuar mospasjen e lidhjeve të subjektit të rivlerësimit me personat e tretë të referuar në këto transaksione.

72.1. Trupi gjykues, pas hetimit të kryer, nuk konstatoi *indicie* që mund të ngrenë dyshime të arsyeshme për lidhjen e personave të tretë me subjektin e rivlerësimit apo personat e lidhur me të, në kuptim të nenit 3 pika 14 dhe nenit 32 pika 4 të ligjit nr. 84/2016.

⁷⁶ Shih pyetësorin nr.4.

⁷⁷ Përgjigje ndaj kërkesës së z. A. R. nga ana e shkollës “****”, Mbretëria e Bashkuar, printim nga emaili, e përkthyer dhe noterizuar; transfertë bankare nga banka “****”, Angli, datë 23.9.2004 me dërgues H. Ll. dhe me përfitues A. R., kopje e njësuar me origjinalin, e përkthyer dhe noterizuar; vërtetim datë 14.9.2004 që provon faktin që A. R. ka qenë student në “****” gjatë vitit akademik 2003-2004, kopje e njësuar me origjinalin, e përkthyer dhe noterizuar; letër datë 3.9.2004, që provon faktin se A. R. është pranuar në “****” kopje e njësuar me origjinalin, e përkthyer dhe noterizuar; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.6.2021 e z. N.R. në lidhje me burimin e transfertave nga llogaritë bankare të z. H. Ll. në drejtim të llogarive bankare të z. A. R.; certifikatë familjare e dajës tim N. R.; të dhëna mbi regjistrimin e biznesit të vogël “Bar-Kafe”, në emër të E. R., bashkëshortes së dajës N. R., për periudhën 1994 – 2006; mandatpagesa të derdhjeve në bankë të detyrimeve tatimore për biznesin e vogël në emër të E. R., në shumën rreth 60.000 lekë tatim fitimi në vit; ekstrakt historik i biznesit të vogël “Bar-Kafe”, në emër të E. R. prej vitit 2003 printim QKB dhe nga sistemi “Customs and Taxation System”; vërtetim nga banka “Raiffeisen Bank”, nga ku vërtetohet se nuk ka të dhëna të ruajtuara përpara vitit 2004.

Mbi shpenzimet e arsimimit të personit të lidhur z. E. Z. në Austri, Vienë në vitin 2017

73. Gjatë hetimit administrativ, është konstatuar se në DPV/2017 subjekti ka deklaruar: *shpenzime për arsim (kursi përgatitor për pranimin V*** U** E*** and B***, në Vienë Austri) për personin e lidhur E. Z. (i biri i deklaruesit) burimi i financimit (kursime dhe ndihmë nga familjarët e deklaruesit), shuma 6,000 euro...* ndërsa në seksionin të ardhurat nga angazhimet në veprimtari publike ose private ka deklaruar: *të ardhura në cash nga familjarët e mi si ndihmë për arsimin e djalit madhor, i biri i deklaruesit E. Z. (kurs përgatitor për pranimin në V*** U*** E*** and B*** Vienë Austri në shumën 4,000 euro... ”... ”...Të ardhura në cash nga personi i lidhur E. Z. si kursime të punës së tij si bar –tender në krocierën “***” Amerikë (shkurt – maj 2016) dhe punë sezonale si kamarier... ”*

73.1. Më tej, e pyetur⁷⁸nga Komisioni, subjekti ka sqaruar se për krijimin e shumës 6000 euro kanë shërbyer; shuma rreth 2.000 euro kursime të mëparshme nga puna e të birit E. Z. si ndihmësbanakier në firmën e kruazierës “***” me zyra në Shtetet e Bashkuara, shuma 2.000 euro nga i ungji z. L. Z. deri në shtator 2017; shuma 2.000 euro nga halla e tij, znj. P. K. në shtator 2017. Subjekti për këtë deklarim ka paraqitur dokumentacion: i) deklaratë noteriale datë 26.4.2021, e znj. P. K., në lidhje me dhënien e shumës prej 3,000 dollarësh kanadezë për shkollimin e nipit të saj z. E. Z., e paraqitur jo në formën e kërkuar nga ligji; ii) dokumente të të ardhurave të shtetasve A. K. dhe P. K. për vitet 2016 dhe 2017, të paraqitur jo në formën e kërkuar nga ligji; iii) deklaratë noteriale nr. ** rep., nr. *** kol, datë 18.5.2020 e z. L. Z.; iv) *Statement* nga BKT për z. L. Z.; v) vërtetim page për E. Z. nga “***” gjatë punës si ndihmësbanakier (maj 2016) jo në formën e kërkuar nga ligji;

a) Të ardhurat nga punësimi i personit të lidhur E. Z. në “*”**

a.1. Në vijim, gjatë hetimit të kryer, u konstatuar se në deklaratën periodike vjetore 2016 dhe në deklaratën “Vetting”, as subjekti dhe as personi i lidhur me të, djali i saj, nuk kanë deklaruar të ardhura nga punësimi, por në deklaratën periodike vjetore 2017 subjekti ka deklaruar: *“...Të ardhura në cash nga personi i lidhur E. Z. si kursime të punës së tij si bar –tender në krocierën “***”Amerikë (shkurt – maj 2016) dhe punë sezonale si kamarier... ”.*

a.2. Referuar ISSH-së⁷⁹ konfirmohet se personi i lidhur E. Z. ka qënë i punësuar në periudha të shkurtra kohore disa mujore përgjatë viteve 2013-2015 në shoqëritë “***”, “***” Tirana, “***” dhe “***”, por gjatë kësaj periudhe nuk janë deklaruar të ardhura të krijuara në deklaratat periodike vjetore.

a.3. Pas verifikimit të dokumentacionit⁸⁰ në lidhje me këto të ardhura të përfituara, Komisioni kërkoi nga subjektit të paraqiste dokumentacionin në formën e kërkuar ligjore, si dhe të provonte burimin e ligjshëm të të ardhurave, në kuptim të nenit D pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

74. Në shpjegimet përfundimtare të saj, subjekti e ka konsideruar të drejtë konstatimin e Komisionit për mosdeklarimin e kësaj shume në mënyrë korrekte në DPV e vitit 2016 dhe sipas saj mosdeklarimi nuk ka pasur asnjë motiv tjetër, përveç mungesës së vëmendjes mbi këtë shumë të ruajtur në arkën e kursimit të djalit dhe të rikthyer në kujtesë një vit më vonë në DPV/2017. Subjekti ka kërkuar të merret në konsideratë kjo harresë nga ana e saj dhe ta përfshihet shuma 2000 euro në analizën financiare. Gjithashtu, ajo ka shpjeguar se në lidhje me dokumentacionin justifikues të punësimit të djalit E. Z. në “***”, nuk ka mundur të sigurojë përgjigje prej kompanisë, si dhe ka paraqitur një komunikim elektronik të fundit me djalin e

⁷⁸Pyetësi nr. 2.

⁷⁹Shkresa kthim përgjigjeje nr. ***, datë 11.9.2019 nga ISSH-ja.

⁸⁰Pyetësi 2 dhe 3.

saj E. Z., sipas të cilit rezulton se është në pritje të përgjigjes nga ana e departamentit të burimeve njerëzore të “****”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

75. Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve dhe kërkesës së subjektit për të përfshirë të ardhurat në shumën 2000 euro në analizën financiare dhe pasi analizoi provat dhe ligjin në fuqi, vlerëson se, Komisioni kryen rivlerësimin e subjekteve në bazë të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Ky ligj u ka dhënë mundësinë subjekteve të deklarojnë në deklaratën e rivlerësimit kalimtar pasuritë, të ardhurat e tyre të akumuluar gjatë viteve dhe të dorëzojnë dokumentacionin justifikues në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre, sipas pikës 7 të udhëzimit nr. ***, datë 10.10.2016 “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë”.

75.1. Subjekti nuk i ka deklaruar të ardhurat në shumën 2000 euro në deklaratën e pasurisë së vitit 2016 dhe as në “Vetting”. Më tej, gjatë hetimit administrativ, subjektit iu dha mundësia të paraqiste dokumentacionin në formën e kërkuar ligjore, në kuptim të nenit D, pika 3. Subjekti nuk arriti të provonte se të ardhurat e përfituara nga i biri në kruazieren gjatë vitit 2016, janë të ardhura të ligjshme, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe për këtë arsye, nuk u konsideruan si të ardhura të ligjshme nga Komisioni.

b) Të ardhurat nga ndihmat nga personat e tjerë të lidhur kunati L. Z. dhe kunata P. K.

b.1. Subjektit iu kërkuar gjithashtu⁸¹ paraqitja e dokumentacionit justifikues për të ardhurat e krijuara nga personi tjetër i lidhur L. Z., në përgjigje të të cilit ka sqaruar se paga mesatare e tij ka qenë 62,000 – 65 000 lekë në muaj, që në 4 muaj rezulton 2000 euro dhe kanë qenë kursime familjare të tij. Kjo shumë i është vënë në dispozicion djalit të subjektit, E. Z. Për të provuar deklarimet e saj subjekti ka bashkëlidhur dokumentacioni përkatës⁸².

b.2. Nga administrimi i dokumentacionit, u evidentua se z. L. Z., gjatë viteve 2014-2017 ka qenë i punësuar në Polici me të ardhura totale në shumën 3,206,722 lekë dhe se shuma e dhënë nipit të tij z. E. Z., është në masën 8.3% e totalit të të ardhurave të tij. Pra, rezulton se z. L. Z. ka pasur mundësi për dhënien e shumës 2,000 euro nipit të tij z. E. Z.

b.3. Në lidhje me dhurimet e kryera nga kunata e saj znj. P. K., për qëllim arsimimi të të birit si dhe disa dhurime⁸³ të tjera në shuma të vogla ndër vite, të konstatuara nga hetimi nëpërmjet institucioneve të transfertave të parave, Komisioni kërkoi nga subjekti justifikimin e burimit të ligjshëm të krijimit të të ardhurave nga znj. P. K., si person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

b.4. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti në formën e kërkuar ligjore deklaratë noteriale të shtetas P. K., datë 26 prill 2021, si dhe disa deklarata të ardhurash vjetore të shtetasve A. dhe P. K. në Kanada, të paraqitura jo në formën e kërkuar ligjore.

b.5. Komisioni administroi dy deklarata noteriale të shtetas P. K. datë 26 prill 2021, sipas të cilës është deklaruar *se në muajin shtator 2017 i ka dhënë shumën 3000 dollarë kanadezë znj. Alketa Zifla me qëllim përdorimin e tyre për shkollimin e djalit të saj E. Z. Këtë shumë, e ka dhënë mundësinë e kthimit të të gjithë shumës apo të një pjese të saj prej nipit tim pas përfundimit të shkollës dhe fillimit të marrëdhënieve të punës.* Ndërsa sipas deklaratës tjetër ka konfirmuar dhurimet e dhëna ndër vite fëmijëve të subjektit në raste eventesh.

⁸¹Pyetësori nr. 3.

⁸²Llogari rrjedhëse në emër të L. Z. në bankën “Raiffeisen” për periudhën 2014-2017; llogari rrjedhëse në emër të L. Z. në BKT, për periudhën 2014-2016; llogari rrjedhëse në emër të L. Z. në BKT për periudhën 2014-2016;

⁸³Shkresa nr. *** prot., datë 19.9.2019, nga “****”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

76. Pas administrimit të shpjegimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti me rezultatet e hetimit, trupi gjykues vlerëson se deklarata noteriale në lidhje me justifikimin e dhurimeve/huas, lëshuar nga zonja P. K., përfaqëson vetëm vullnetin e saj në lidhje me to, por nuk provon nëse ajo dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të ligjshme për të kryer dhurimet/huan. Në këtë kontekst, këto dhurime/hua nuk mund të konsiderohen në analizën e Komisionit, për sa subjekti nuk arriti të provojë ligjshmërinë e krijimit të tyre nga P. dhe A. K., sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit 84/2016.

76.1. Pas kryerjes së analizës financiare për vitin 2017, subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri financiare në shumën **-904 448⁸⁴** lekë për të përballuar me burime të ligjshme në kuptim të nenit D pika 3 shpenzimet e arsimimit të djalit të saj.

Në lidhje me huan e marrë nga personi i lidhur E. Z. në shumën 7,000 euro, nga shtetasi L. Ç.

77. Në deklaratën periodike vjetore 2017, djali i subjektit ka deklaruar: *“Të ardhura për arsim (leje qëndrimi në Austri) Burimi i financimit: hua nga bashkëstudentë shqiptarë të depozituara në llogarinë rrjedhëse (I*** s*** U*** nr ***) në shumën 7,000 euro...”*. Gjithashtu, personi i lidhur ka deklaruar: *“...Shpenzime për shlyerjen e huas të marrë për lejen e qëndrimit në Austri (tërhequr nga llogaria rrjedhëse: I*** s*** U*** nr ***) në shumën 7,000 euro...”*

77.1. Komisioni kërkoi nga subjekti informacion dhe dokumentacion provues⁸⁵ në lidhje me këtë hua, mënyrën e përfitimit dhe të kthimit të saj, si dhe burimin e krijimit të shumës së dhënë nga huadhënësi z. L. Ç.

77.2. Subjekti ka sqaruar se shuma është depozituar në bankën “****” Austri, në shumën 7.000 euro në datën 23.10.2017 për aplikimin e lejes së qëndrimit dhe është rikthyer për një periudhë të shkurtër kohore, menjëherë pas tërheqjes së tyre në datën 13.12.2017, shtetasit L.C. Gjithashtu, ka paraqitur dokumentacion provues⁸⁶.

77.3. Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, konkludon se huaja është dhënë dhe kthyer brenda vitit dhe se subjekti nuk ka pasur detyrim ta deklarojë në deklaratën “Vetting”. Kjo hua, gjithashtu nuk ka ndikim në analizën financiare të pasurive të subjektit.

Në lidhje me analizën financiare 2003 – 2017

78. Pas dërgimit të barrës së provës mbi rezultatin e analizës financiare, subjekti paraqiti disa objeksione në lidhje me shpenzimet, për të cilat trupi gjykues vlerëson se: i) në lidhje me shpenzimet e qëndrimit të personit të lidhur K. Z., në periudhën 2.7.2017-15.7.2017 në Austri, pas dërgimit të dokumentacionit provues⁸⁷ mbi mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit, shpenzimet për vitin 2017 janë reduktuar në vlerën prej 675⁸⁸ euro në total; ii) në lidhje me shpenzimet e qëndrimit të fëmijëve të saj në Kanada në vitin 2010, pas dërgimit të

⁸⁴ Referohu tabelës analiza financiare në fund të vendimit.

⁸⁵Pyetësori nr. 2.

⁸⁶ “Statement” e llogarisë bankare të djalit tim E. Z. në bankën “****” Austri; dokument mbi gjendjen e llogarisë së E. Z. më 23.10.2017; dokument identifikues si student për L. Ç. (kartë studentore), bashkëstudent i të birit E.Z.; dokument justifikues për burimin e të ardhurave për L. Ç. datë 7.7.2017; dokument i thjeshtë në formën e deklaramit në anglisht, datë 7.7.2017 me titull “****” drejtuar “****”, Vienë nga T. dhe E. Ç., në të cilën deklarohen T. Ç. si i vetëpunësuar dhe E. Ç. si mësuese në shkollën fillore dhe me të ardhurat e tyre i kanë dhënë djalit të tyre L. Ç. shumën 12,000 euro për studimet.

⁸⁷ Korrespondencë elektronike midis personit të lidhur K. Z. dhe “G*** I*** S*** S***”, në të cilën konfirmohet mbulimi i shpenzimeve të qëndrimit në Gjermani.

⁸⁸ Duke rillogaritur për këtë periudhë shpenzimet e qëndrimit me 5 euro /ditë.

dokumentacionit provues⁸⁹ mbi mbulimin e shpenzimeve nga halla e tyre znj. P. K., analiza e vitit 2010 rezulton me mjaftueshmëri financiare.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin pasuror

79. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri financiare në shumën - **904 448 lekë** në vitin 2017 për të përballuar me burime të ligjshme shpenzimet e arsimimit të djalit të saj në kuptim të pikës 3, nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 pika 5 b) të ligjit nr. 84/2016.

79.1. Nga vlerësimi në tërësi i veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me përfitimin e pasurisë apartament prej 59 m² në Tiranë, subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

B. KONTROLLI I FIGURËS

80. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka apo ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

80.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin mbi kontrollin e figurës⁹⁰ për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

80.2. Në përfundim të veprimeve verifikuese, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr.84/2016, DSIK-ja ka konkluduar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit znj. Alketa Zifla.

80.3. Nga hetimi i pavarur i Komisionit në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

80.4. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

⁸⁹ Viza kanadeze dhe vulat e lëvizjeve në pikat e kalimit kufitar, kopje të njësuar me origjinalin; letër garanci e znj. P. K., të paraqitur në 27.2.2010 pranë ambasadës kanadeze në Romë, së bashku me biletat e fëmijëve, printuar nga e-maili personal.

⁹⁰ Raport me nr. *** prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 30.03.2021.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Raporti profesional i përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë⁹¹

81. Raporti profesional është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

81.1. Ky raport është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: i) formularit të vetëdeklarimit plotësuar nga subjekti për periudhën 1.1.2014⁹² - 31.12.2016, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; ii) 3 (tri) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; iii) 5 (pesë) dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor⁹³; iv) Të dhënave nga 23 prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informativë dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

81.2. Sipas raportit janë analizuar të dhënat nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016, në përfundim të të cilit, kanë rezultuar këto gjetje:

a) **Për aftësitë profesionale:** ka aftësi të mira në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta.

b) **Për aftësitë organizative:** ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet dhe ka aftësi në menaxhimin e procedurave hetimore.

c) **Për etikën dhe vlerat profesionale:** është vlerësuar “shumë mirë” nga Prokurori i Përgjithshëm për etikën profesionale dhe nuk ka të dhëna për cenim të imunitetit të saj nga presioni i jashtëm. Nuk ekzistojnë shkaqe për paanësi të dokumentuar.

d) **Për aftësitë personale:** shfaq aftësi komunikuese të mira si dhe bashkëpunimi dhe ka marrë pjesë në trajnime profesionale.

Të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore - vlerësimet)

81.3. Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme nuk rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit Alketa Zifla, të jenë marrë masa disiplinore. Gjithashtu rezulton se nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të regjistruar ndaj saj. Ndërsa në lidhje me ankesat, kanë rezultuar të regjistruara në Prokurorinë e Përgjithshme 5 ankesa⁹⁴ ndaj subjektit të rivlerësimit, të cilat pas administrimit, 2 prej tyre janë arkivuar për sa nuk kanë pasur shkaqe për hetime të

⁹¹ Raport profesional nr. *** prot., datë 24.2.2020.

⁹²(Shënim: pasaktësia apo mospërputhja e të dhënave ka lidhje me faktin se, vetëm në tetor 2017, është vendosur në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit që të jepen të dhënat statistikore të subjekteve të rivlerësimit për tre vitet e fundit nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, që përkon me periudhën 8 tetor 2013 deri 8 tetor 2016, ndërkohë që, formulari i vetëdeklarimit është plotësuar nga subjekti i rivlerësimit për 3 vitet e fundit kalendarike 2014, 2015 dhe 2016).

⁹³Dosje nr.1- është cilësuar kallëzimi penal nr. ***, viti 2015. (akti – vendimi i mosfillimit); dosje nr.*** është cilësuar procedimi penal nr. ***. (akti – vendimi i pushimit); dosje nr. *** është cilësuar procedimi penal nr. ***. (akti – vendimi i pushimit); dosje nr. *** është cilësuar procedimi penal nr. ***. (akti - kërkesë për gjykim); dosje nr. 5 është cilësuar procedimi penal nr. ***. (akti - kërkesë për për gjykim).

⁹⁴ 1) Ankesa e shtetasit R. P., praktika nr. ***; 2) ankesa e shtetasit V.T., praktika nr. ***; 3) ankesa e shtetasit R. R., praktika nr. ***; 4) ankesa e shoqatës “****”, praktika nr. *** dhe nr. ***; 5) Ankesa e shtetasit M.V., praktika nr. ***.

mëtejshme, ndërsa 3 të tjera janë orientuar për zgjidhje, duke vënë në dijeni edhe subjektin e rivlerësimit.

DENONCIMET

82. Pranë Komisionit janë regjistruar 5 (pesë) denoncime⁹⁵, 2 (dy)⁹⁶ prej të cilëve iu kaluan subjektit për shpjegime. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime shteruese, si dhe dokumentacion mbështetës, të cilat u administruan nga Komisioni dhe nuk u gjetën indicie në kuptim të vlerësimit të kriterit profesional.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

83. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tre dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore, mbi të cilat është hartuar raporti. Gjithashtu, i kërkoi⁹⁷ informacion Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me çdo ankesë, procedim disiplinor, procedim penal ndaj subjektit të rivlerësimit, në përfundim të të cilit, nuk u gjetën *indicie* në lidhje me kriterin profesional ndaj subjektit të rivlerësimit.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin profesional

84. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Zifla ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

85. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi vlerësoi çështjen në tërësi në kuptim të nenit 4 pika 2, bazuar në provat e administruara si dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, ka kryer një sërë veprimesh juridike fiktive/të simuluar, të cilat nuk përputhen me sjelljen etike që një magjistrat/prokuror pritet të ketë, duke cenuar për rrjedhojë besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë; ka mungesë të burimeve të ligjshme për të përballuar shpenzimet në vitin 2017, duke rezultuar me pamjaftueshmëri në shumën - **904 448 lekë**.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, bazuar në nenin 58, pika “c”, si dhe 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁹⁵ Dy denoncime të shtetases V. T., me nr. *** prot., datë 5.1.2021, si dhe me nr. *** prot., datë 12.5.2021 me objekt “kundërshtimin e vendimit të mosfillimit; 1 denoncim i shtetases R. Rr., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 1.6.2018 me objekt “moskryerje hetimesh”.

⁹⁶ Denoncim i shtetasis A. V. regjistruar në Komisioni me nr. *** prot., datë 30.8.2019 dhe denoncim i shtetasis M. H., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 4.4.2019.

⁹⁷ Shkresë *** prot., datë 11.9.2019 dhe kthim përgjigjeje me nr. *** prot., datë 22.11.2019, si dhe shkresat dhe dokumentacioni mbështetës i dërguar nga prokuroritë e rretheve.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Zifla, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose nga Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 16.6.2021

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda Çiftja

Kryesues

Xhensila Pine

Anëtare

Pamela Qirko

Relatore

Ertugena Sokoli
Sekretare gjyqësore

Analiza financiare përfundimtare – Aneks 1

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
A) PASURI	0	100,000	3,118	56,670	-145,907	-94,105	125,869	-158,088	254,270	3,559,175	5,816	11,789	-28,682	6,191	832,298
Apartament banimi me sip 84 m2, pronë e Entit Kombëtar të Banesave e pahipotekuar L"****, Pallati ***, Tepelenë (Viti i krijimit 1995) /// Apartament banimi fituar me kontratë të shijës me këste dhe kusht datë 25.05.2006. Ap është marrë më 1995 me VKB. Disponoj 40m2. /// Apartament banimi 44m2, fituar në 1995, me VKB të Bashkisë Tepelenë, sipas kontratës së shijës me këste dhe kusht datë 25.05.2006 me Entin e Banesave me këst mujor 1,200 lekë për një afat 14 vjet.															
Objekt magazinë sip 185 m2 + Truall e blerë në dt. 04.05.2004		100,000													
Autoveturë AUDI blerë me kontratë nr *** Rep nr *** datë 22.05.2000															
Apartament banimi me sip 59m2 të ndodhur në Tiranë, BLV *****, Pallati ***, Shk *** Ap *** identifikuar, me nr pasurie ***, ***, ZK *** blerë me kredi të lehtësuar përfituar nga Bashkia Fier dhe BKT.										3,500,000					
Ndryshim likuiditeti	0	0	3,118	56,670	-145,907	-94,105	125,869	-158,088	254,270	59,175	5,816	11,789	-28,682	6,191	832,298
TOTAL LIKUIDITETE	0	0	3,118	59,788	-86,119	-180,224	-54,355	-212,443	41,827	101,002	106,818	118,607	89,925	96,116	928,414
B) DETYRIME	0	0	0	0	0	250,000	0	42,900	0	3,500,000	0	0	100,000	250,000	930,650
Kredia pranë Bankë Popullore (OTP BANK) dt 04.11.2008 (disb shuma 250,000 lekë)						250,000									
Kredia pranë Bankës BKT dt 30.03.2012 (disb shuma 3,500,000 lekë)										3,500,000					
Kredia pranë Bankës Raiffeisen blerje lvartrçe 29.12.2010 (disb shuma 42,900 lekë)								42,900							
Kredia pranë Bankës Credins dt 22.09.2015 (shuma 100,000 lekë)													100,000		
Kredia pranë Bankës BKT dt 16.12.2016 (disb shuma 250,000 lekë)														250,000	
Detyrim (hua) nga bashkëstudentë Shqiptarë (shuma 7,000 euro)															930,650
C) PASURI NETO (A-B)	0	100,000	3,118	56,670	-145,907	-344,105	125,869	-200,988	254,270	59,175	5,816	11,789	-128,682	-243,809	-98,352
D) TË ARDHURA	898,794	1,328,844	1,424,024	1,413,238	1,355,198	1,242,448	1,544,366	1,465,512	1,942,117	2,025,473	2,439,868	1,858,020	1,848,860	1,939,030	2,633,425
Të ardhura nga paga SR	759,557	1,151,344	1,249,180	1,158,974	1,055,500	851,599	894,732	1,074,110	1,176,964	1,372,576	1,454,740	1,177,892	1,246,784	1,245,748	1,256,875
Të ardhura nga paga bashkëshorti	139,237	177,500	174,844	254,264	299,698	282,849	362,254	381,459	424,338	398,460	386,425	557,900	530,719	199,918	
Të ardhura nga honoraret bashkëshorti						108,000	270,000		330,060		400,000				
Të ardhura nga vendimi i gjykatës (nga ish - bashkëshorti)														90,000	180,000
Të ardhura të tjera ndihmë nga babai H. L.										236,810	190,754	113,641	69,912	132,824	265,900
Të ardhura të tjera (ndihmë nga kunati L. Z. për shkollimin e E. Z.)															930,650
Hua nga L. Ç. (shuma 7,000 euro) për garanci studentore															270,540
Të ardhura nga paga (kroçjera) personi i lidhur E. Z.															-
Të ardhura nga interesat e depozitës personi i lidhur E. Z.							15,605	5,902	6,202	11,067			1,445,000		
Të ardhura nga interesat e depozitës personi i lidhur K. Z.							1,775	4,041	4,553	6,560	7,949	8,587			
E) SHPENZIME	375,456	375,456	607,333	507,011	1,137,876	1,098,785	1,051,488	1,146,535	1,213,321	1,142,798	1,314,353	1,667,018	1,736,127	2,058,437	3,636,226
Shpenzime jetike	375,456	375,456	438,228	470,345	683,100	683,100	683,100	683,100	683,100	705,120	705,120	1,099,990	1,121,380	968,493	871,451
Shpenzime per apartamentin në Tepelenë (EKB)				14,400	14,400		12,000	37,200	7,200	15,000	14,400	25,000	6,000	14,400	
Shpenzime mobilimi apartamenti e marrë me qira në FIER						200,000									
Shpenzime për këstin e kredisë pranë Bankës Popullore (OTP BANK) dt 04.11.2008 (disb shuma 250,000 lekë)							12,599	151,188	138,589						
Shpenzime për këstin e kredisë pranë Bankës BKT dt 30.03.2012 (disb shuma 3,500,000 lekë)										223,717	242,568	247,017	246,649	246,524	221,234
Shpenzime për këstin e kredisë pranë Bankës Raiffeisen blerje lvartrçe 29.12.2010 (disb shuma 42,900 lekë)								3,000	47,557						
Shpenzime për këstin e kredisë pranë Bankës Credins dt 22.09.2015 (shuma 100,000 lekë)													17,909	65,665	29,771
Shpenzime për këstin e kredisë pranë Bankës BKT dt 16.12.2016 (disb shuma 250,000 lekë)														6,250	134,416
Shpenzime për arsimin e personit të lidhur E. Z. në Vienë Austri															797,700
Shpenzim për kthim detyrimi (hua) për garanci studentore (shuma 7,000 euro) L. Ç.															930,650
Shpenzime udhëtimi			169,105	22,267	395,376	11,086	0	134,646	287,664	19,561	176,665	14,011	35,789	221,505	351,004
Shpenzime për rregullime shtëpie															250,000
Shpenzime për pagesë qiraje në Gjirokastrë					45,000	165,000									
Shpenzime për pagesë qiraje në Fier						15,000	180,000	180,000	180,000	180,000	165,000				
Shpenzime për pagesë qiraje në Tiranë												300,000	300,000	300,000	300,000
Analiza Financiare (D-C-E)	523,338	853,388	813,573	849,557	363,229	487,768	367,009	519,965	474,526	823,500	1,119,699	179,213	241,415	124,402	-904,448